



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete

**REGJISTRIMI CIVIL I PERSONAVE QË U PËRKASIN
KOMUNITETEVE ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIANË
GJETJET NGA AKTIVITETI MONITORUES**

11 DHJETOR 2006 - 15 JANAR 2007

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. HISTORIKU	5
3. METODOLOGJIA.....	8
4. NIVELI I NJOHJES SË REKOMANDIMEVE TË ZKM-SË PËRKITAZI ME REGJISTRIMIN CIVIL TË ROMËVE, ASHKALIVE DHE EGJIPTIANËVE	8
5. TARIFAT E REGJISTRIMIT CIVIL.....	11
5.1. ÇMIMI DHE MUNDËSIA E PAGIMIT TË TARIFAVE KOMUNALE	11
5.2. LIRIMI NGA PAGESAT E TARIFAVE KOMUNALE	13
6. NISMAT KOMUNALE PËR LEHTËSIMIN E REGJISTRIMIT CIVIL TË ROMËVE, ASHKALIVE DHE EGJIPTIANËVE.....	15
6.1. MASAT LEHTËSUESE	15
6.1.1 PËRDORIMI I EKIPEVE LËVIZËSE TË REGJISTRIMIT	21
6.1.2 INICIATIVAT E ZKK-VE DHE ZYRTARËVE KOMUNALË TË KTHIMIT PËR VETËDIJESIMIN E ROMËVE, ASHKALIVE DHE EGJIPTIANËVE PËR REGJISTRIMIN CIVIL	23
6.1.3 TAKIMET KOORDINUESE TË BARTËSVE	25
6.2. MASAT E FLEKSIBILITETIT	25
6.2.1. FAKTET E PRANUARA NGA QKRC-TË SI PROVË E ZHVENDOSJES ME FORCË	26
6.2.2. FAKTET E PRANUARA NGA QKRC-TË SI PROVË E IDENTITETIT DHE TË DREJTËS PËR T’U REGJISTRUAR	29
6.2.3. PROCEDURA ME DËSHMITARË	32
6.2.4. PRANIA PERSONALE E APLIKANTIT	37
7. NDIKIMI I FUSHATËS	40
8. REKOMANDIME.....	45

Shkurtesat dhe përkufizimet

Regjistrimi civil: për qëllimet e këtij raporti, termi regjistrim civil është një term i përgjithshëm i përdorur në kuptimin e regjistrimit të gjendjes civile dhe të regjistrimit si banor i përhershëm i Kosovës, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Regjistrimi i banorit të përhershëm: për qëllimet e këtij raporti, termi regjistrim i banorit të përhershëm është një term specifik i përdorur në kuptimin e regjistrimit si banor i përhershëm i Kosovës, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Regjistrimi i gjendjes civile: për qëllimet e këtij raporti, termi regjistrimi i gjendjes civile është një term specifik i përdorur në kuptimin e regjistrimit të fakteve lidhur me lindjen, martesën, vdekjen dhe gjendjet e tjera civile të aplikantit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

KiK: Kuvendi i Kosovës

Rekomandimet: Rekomandimet e ZKM-së për Azhurnimin e Politikave dhe Procedurave të Kthimit, të 24 majit 2006

KE: Këshilli i Evropës

PDCK: Programi për të Drejtat Civile në Kosovë

KDR: Këshilli Danez për Refugjatë

FCNM: Konventa Kornizë e KE-së për Pakicat Kombëtare

‘GTZ’: Asociacioni për Bashkëpunim Teknik

KMKN: Komisioni i Migracionit Katolik Ndërkombëtar

KKK: Kryetari i Kuvendit Komunal

ZKK: Zyra Komunale për Komunitete

ZKGjC: Zyra Komunale për Gjendje Civile

QKRC: Qendra Komunale për Regjistrim Civil

MAPL: IPVQ, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MPB: IPVQ, Ministria e Punëve të Brendshme

MiM: Memorandum i Mirëkuptimit

MShP: IPVQ, Ministria e Shërbimeve Publike

EK: Ekipi Komunal i OMiK-ut

GPKK: Grupi Punues Komunal për Kthim

NKN: Ndihma e Kishës Norvegjeze

OJQ: Organizatë joqeveritare

‘OMiK’: Misioni i OSBE-së në Kosovë

‘OMiK’ QR: Qendrat rajonale të OMiK-ut

ZKM: IPVQ, Zyra e Kryeministrit

IPVQ: Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes

PNjK: IPVQ, Pilot-njësi komunale

PAK: Person me aftësi të kufizuara

RS: Republika e Serbisë

RSFJ: Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

‘UNHCR’: Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë

‘UNMIK’: Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

UNMIK ZQRC: Zyra Qendrore e Regjistrimit Civil të UNMIK-ut

Fletushkë e ZQRC-së së UNMIK-ut: Fletushkë Informative e Zyrës Qendrore të UNMIK-ut për Regjistrim Civil mbi Procedurat për Regjistrim Civil dhe Dokumente të Udhëtimit

UNMIK/DAC: Departamenti i UNMIK-ut për Administratë Civile

1. Përmbledhje ekzekutive

Më 24 maj 2006, Zyra e Kryeministrit (ZKM) në Kosovë nxori Rekomandimet për Azhurnimin e Politikave të Kthimit dhe Procedurave (në tekstin e mëtutjeshëm 'Rekomandimet') dhe i udhëzoi Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) dhe komunat "të sigurojnë që kërkesat në pritje për regjistrim të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të përfundohen brenda gjashtë muajve të ardhshëm. Ndaj këtyre grupeve, nuk do të zbatohen pagesat e vonuara për këto shërbime administrative." Në shtator të vitit 2006, me qëllim të përkrahjes së veprimeve të ZKM-së, Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) ndërmori një fushatë të regjistrimit civil që kishte për synim pjesëtarët e këtyre komuniteteve.

Nga dhjetori i vitit 2006 deri në janar të vitit 2007, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK) i monitoroi praktikat komunale në lidhje me regjistrimin e aplikantëve të padokumentuar të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas. Ky raport përmban gjetjet e këtij aktiviteti monitorues.

Zbatimi i Rekomandimeve u ndikua negativisht nga fakti se ato nuk kishin fuqi ligjore, shpërndarja e tyre nëpër zyrat relevante komunale nuk ka qenë adekuate dhe për shkakun se ato më vonë nuk u përcollën me udhëzime me shkrim, ku do të përshkruheshin në hollësi obligimet specifike të sjelljes dhe të zbatimit për IPVQ-të dhe komunat. Në disa raste, zyrtarët komunalë me sa dukej nuk ishin fare në dijeni për ekzistimin e Rekomandimeve, ndërsa të tjerët pohonin se nuk kishin njohuri për përmbajtjen e tyre. Disa komuna kanë ndërmarrë masa konkrete për të lehtësuar regjistrimin civil të aplikantëve romë, ashkali dhe egjiptas, ndërkaq vetëm gjashtë sosh i kishin liruar aplikantët romë, ashkali dhe egjiptas nga tarifat e regjistrimit të gjendjes civile. Mungesa e udhëzimeve të mëtejshme me shkrim ka bërë që shumica e komunave të mos kenë qasje fleksibile sa i përket regjistrimit civil të aplikantëve romë, ashkali dhe egjiptas.

Gjithashtu, në raport theksohen disa praktika komunale pozitive, përsëritja dhe përhapja e të cilave mund të kontribuojë në përmirësimin e përpjekjeve të vazhdueshme të IPVQ-ve.

Ndërprerja e ciklit të përjashtimit nga regjistrimi civil është një proces i ndërlikuar dhe i vështirë që kërkon angazhim, përkushtim dhe përkrahje si nga institucionet qendrore, ashtu edhe nga ato komunale. Përveç Rekomandimeve dhe iniciativës së UNHCR-së për të ndërmarrë një fushatë për promovimin e regjistrimit civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, sigurimin e ndihmës ligjore dhe lehtësimin e regjistrimit civil të personave të padokumentuar, institucionet e regjistrimit civil, po ashtu, duhet të marrin përkrahje të duhur nga IPVQ-të qendrore dhe komunale. Është përgjegjësi e bartësve të përfshirë, shoqërisë si tërësi dhe IPVQ-ve që ta shndërrojnë situatën nga një problem të padukshëm dhe shpesh të shpërfillur në një çështje me rëndësi publike.

2. Historiku

Në nenin 16 të Paktit ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike¹ thuhet: “secili ka të drejtë t’i njihet personaliteti juridik kudo qoftë”. Regjistrimi civil është parakusht themelor për qasje në të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Përmes regjistrimit civil, personi ka të krijuar identitetin e tij/saj para ligjit dhe i njihet situata e tij/saj juridike dhe statusi ligjor përkitazi me familjen dhe shoqërinë. Regjistri i gjendjes civile është dokumenti i vetëm zyrtar publik që dëshmon gjendjen civile të një personi në familje, shoqëri dhe shtet. Regjistrimi civil është thelbësor, sepse deklaron lindjen e personit para ligjit. Ai përfshin njohjen e emrit të personit, e drejtë nga e cila personi nuk mund të heqë dorë, që e identifikon personin si pjesë përbërëse të shoqërisë në të cilën ai/a jo jeton dhe zhvillon marrëdhënie juridike. Sistemi ligjor nuk e njeh identitetin e personave të përjashtuar nga regjistrimi civil dhe ata nuk kanë mundësi të realizojnë akte të vlefshme ligjore. Ka të ngjarë që ata të përjashtohen nga ushtrimi i të drejtave dhe obligimeve.

UNHCR-i vlerëson që afërsisht 20 deri 40 % e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, të cilët jetojnë në Kosovë, nuk janë të regjistruar si banorë të përhershëm² dhe se përballen me rrezikun që të mbesin pa shtetësi.³ Duke pasur parasysh se vlerësimet në dispozicion lidhur me numrin e popullatës rome, ashkali dhe egjiptase në Kosovë sillen prej 34,000⁴ deri në 35,500⁵ persona, numri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve pa dokumente mund të arrijë nga 6,800 deri në 13,600 persona. Përveç tjerash, ka shumë mundësi që, një numër i madh i personave nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas nga Kosova dhe që aktualisht jetojnë në vende të ndryshme evropiane, të riatdhesohen pa vullnetin e tyre në Kosovë⁶, sepse nuk i plotësojnë më kushtet për qëndrim në territoret e

¹ E miratuar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe pranim me Rezolutën 2200 A (XXI) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 16 dhjetor 1996; ka hyrë në fuqi më 23 mars 1976, në pajtim me nenin 49.

² Zyra e UNHCR-së në Kosovë – Zyra e Shefit të Misionit (ZShM), Njësia për Mbrojtje, Fushata për Regjistrim Civil që Synon Komunitetin RAE në Kosovë – Plani i Veprimit, korrik 2006, faqe 1.

³ Sipas nenit 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara lidhur me Statusin e Personave pa Shtetësi: ... termi person pa shtetësi do të thotë personi i cili nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet sipas ligjit të tij.” Kjo Konventë u miratua më 28 nëntor 1954, nga një Konferencë e të Plotëfuqishmëve e thirrur me Rezolutën 526 A (XVII), të 26 prillit 1954. Ajo hyri në fuqi më 6 qershor 1960, në pajtim me nenin 39.

⁴ UNHCR-i në Kosovë, ZShM, Njësia për Mbrojtje, Fushata për Regjistrim Civil që Synon Komunitetin RAE në Kosovë – Plani i Veprimit, korrik 2006, faqe 1. UNHCR-ja vlerëson që popullata aktuale RAE në Kosovë arrin në 34,000 persona, përfshirë 11,000 romë dhe 23,000 ashkali dhe egjiptianë.

⁵ Harmonizimi i vlerësimeve mbi popullatën të përfshirë në Profilet e Komunave, të përpiluara nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK) dhe të publikuara në faqe të internetit: <http://www.osce.org/kosovo/13982.html>. Këto profile janë azhurnuar për herë të fundit në maj dhe qershor të vitit 2006.

⁶ Sipas Zyrës së UNMIK-ut për Komunitete, Kthim dhe Çështje të Pakicave (ZKKÇP), numri i personave të riatdhesuar në Kosovë aktualisht është zvogëluar në periudhën nga 2004 (4,084) deri 2005 (3,745) dhe 2006 (3,598). Totali në këtë periudhë arrin në 11,427 persona të riatdhesuar, nga të cilët 5,177 (43.3%) u deportuan vetëm nga Gjermania. Ashtu siç është konfirmuar gjatë një punëtorie mbi “Procedurat e ripranimit për Kosovën – rruga para nesh” organizuar nga ZKKÇP-ja në Prishtinë, më 16 mars 2007, vlerësohet se afërsisht 100,000 kosovarë jetojnë pa status ligjor në vendet e Evropës perëndimore, përfshirë këtu Gjermaninë, Suedinë, Danimarkën, Zvicrën dhe Francën. Afërsisht gjysma e këtyre personave jetojnë në Gjermani, me rreth 36,000 sish që u takojnë komuniteteve pakicë, kryesisht RAE. Legjislacioni i miratuar rishtazi mbi integrimin e të huajve mund të parashohë që gjysmës së kosovarëve pa status ligjor në

atyre vendeve. Në rast se nuk kanë mundësi të kryejnë regjistrimin civil, ky grup mund të ballafaqohet me pengesa serioze për riintegrim dhe nuk do të ketë fare qasje, apo do të ketë qasje të kufizuar në shërbime komunale, arsimim të duhur, punësim dhe mundësi të tjera për riintegrim.

Më 24 maj 2006, ZKM-ja miratoi Rekomandimet. Mes tjerash, “Mekanizmat Shtesë për Minoritetet/të Kthyerit për të Siguruar Mosdikriminim,”⁷ Rekomandimet njohin se “ka kërkesa të pazgjidhura për dokumente të regjistrimit civil” dhe i udhëzojnë qartë komunat “të sigurojnë që kërkesat e pazgjidhura sa i përket regjistrimit të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të përfundohen brenda gjashtë muajve të ardhshëm” dhe se “ndaj këtyre grupeve⁸ nuk duhet të zbatohen pagesat e vonuara për këto shërbime administrative.”

Si pjesë e mandatit të tij mbi njerëzit pa shtetësi, UNHCR-ja ka hartuar një plan veprimi për një “Fushatë të Regjistrimit Civil, që Synon Romët, Ashkalitë dhe Egjiptasit në Kosovë.”⁹ Partneri implementues i UNHCR-së, OJQ-ja Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (PDCK), filloi me zbatimin e fushatës për regjistrim civil në shtator të vitit 2006. Njëkohësisht, UNHCR-ja ka avokuar për IPVQ-të qendrore për të siguruar që komunat në tërë Kosovën të kenë një qasje të harmonizuar dhe fleksibile sa i përket regjistrimit civil të pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas dhe lirimit të tyre nga obligimi i pagesës së tarifave administrative. Si pjesë e kësaj qasjeje, UNHCR-ja ka rekomanduar që Qeveria të hartojë udhëzime të brendshme specifike që u drejtohen të gjitha komunave, qendrave komunale të regjistrimit civil (QKRC) dhe zyrave komunale për gjendje civile (ZKGjC), si dhe ministrive përgjegjëse për regjistrimin civil. Ndërkohë që miratimi i këtyre udhëzimeve është në pritje, UNHCR-ja ka kërkuar ndihmën e OMiK-ut për monitorimin e përputhshmërisë së QKRC-ve dhe ZKGjC-ve me rekomandimet, në pjesën ku ato i referohen regjistrimit civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve dhe lirimit të tyre nga pagesa e tarifave.¹⁰

Sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, ka dy lloje të regjistrimit civil:

- Regjistrimi civil si banor i përhershëm,¹¹ i jep të drejtën personit që të marrë letërnjoftim dhe dokument udhëtimi të UNMIK-ut. Ai parasheh tarifa administrative, me përjashtim të lëshimit fillestar të letërnjoftimeve. Deri më tani, procesi ka mbetur nën autoritetin e UNMIK-ut, veçanërisht sa i përket nxjerrjes dhe zbatimit të ligjeve. Megjithatë, përgjegjësitë menaxhuese dhe operative për

Gjermani t’u jepet mundësia për të aplikuar për qëndrim të përhershëm. Deri më tani, politika e UNMIK-ut për ripranim bazuar në rekomandimet e UNCHR-së të publikuara në dokumentin “Qëndrimi mbi Mbrojtjen e Vazhdueshme Ndërkombëtare të Nevojave të Individëve nga Kosova” (më së fundi e përditësuar në qershor të vitit 2006) ka parandaluar riatdhesimin e serbëve të Kosovës, romëve (përveç rasteve me dënime penale) dhe shqiptarëve të Kosovës në rastet kur ata janë pakicë.

⁷ Rekomandimet e ZKM-së për Azhurnimin e Politikave të Kthimit dhe Procedurave, 24 maj 2006, neni 3.

⁸ Po aty., neni 3c.

⁹ Zyra e UNHCR-së në Kosovë – Njësia për Mbrojtje e ZShM-së, korrik 2006.

¹⁰ Memorandumi i UNHCR-së për Kryesuesin e Misionit të OSBE-së (KiM), i datës 22 shtator 2006.

¹¹ Legjislacioni gjegjës: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil; Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2001/12.

Qendrën Kryesore të Procesimit (QKP) dhe QKRC-të i janë bartur Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Në të njëjtën kohë, Kuvendi i Kosovës (KiK) është në proces të hartimit të një ligji të ri mbi letërnjoftimet;¹²

- Regjistrimi i gjendjes civile¹³ nga zyrat komunale të gjendjes civile (ZKGjC) mundëson regjistrimin e fakteve jetike të gjendjes civile të personit, siç është lindja, martesja dhe vdekja. Tarifat administrative të caktuara nga kuvendet komunale janë të zbatueshme. Të gjitha aktivitetet e ndërlidhura janë nën autoritetin e Ministrisë së Shërbimeve Publike (MShP). Që nga muaji prill 2007, MShP-ja ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me MPB-në, me të cilën Departamenti i Gjendjes Civile bartet nga MShP-ja në MPB. Që nga muaji maj 2007, bartja e tillë e kompetencave është kompletuar, dhe tani MPB-ja e ka përgjegjësinë e plotë edhe për regjistrimin e gjendjes civile. Për këtë qëllim, në kuadër të MPB-së është themeluar Departamenti i Regjistrimit dhe i Gjendjes Civile.

Ndërprerja e ciklit të përjashtimit nga regjistrimi civil është një proces i ndërlikuar dhe i vështirë që kërkon angazhim dhe bashkëpunim të disa institucioneve qendrore dhe komunale. Për këtë, kërkohet që të merret parasysh dhe të trajtohet gjendja specifike e pjesëtarëve të cenusshëm të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në Kosovë, të cilët nuk ekzistojnë para ligjit si rezultat i mungesës së regjistrimit civil. Gjithashtu, për këtë kërkohet miratimi dhe zbatimi i masave pozitive nga institucionet dhe shoqëria për trajtimin e gjendjes ku këta persona janë të pambrojtur, si dhe të sigurojnë njohjen dhe regjistrimin e fakteve bazë të gjendjes së tyre civile dhe të qëndrimit.

Veprimet pozitive duhet të trajtojnë këtë rreth vicioz të përjashtimit nga regjistrimi civil që bartet nga gjenerata në gjeneratë, si dhe kushtet e varfërisë, marginalizimit social, arsimimit të dobët, mospërfilljes, mungesës së vetëdijes, zhvendosjes dhe migrimit që e lehtësojnë vazhdimin e tij. Ato duhet të jenë pjesë e një veprimi më gjithpërfshirës që lidhet me fenomene të tjera të padëshirueshme sociale dhe format e abuzimit, që shpesh ndërlidhen me mungesën e regjistrimit civil: shfrytëzimi i fëmijëve për punë, fëmijët e rrugës, përjashtimi nga arsimimi, situata e pasigurt dhe joformale ekonomike dhe e banimit, qasje e dobët në infrastrukturë dhe shërbime komunale. Duke vepruar kështu, duhet të merret parasysh situata veçanërisht e pafavorshme e vajzave dhe grave romë, ashkali dhe egjiptase, përfshirë këtu cenusshmërinë e tyre ndaj martesave të hershme dhe shpesh të peregjistruara, si dhe të përjashtimit apo braktisjes së shkollimit.

Brenda komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, vazhdojnë të ndodhin një numër lindjesh nëpër shtëpi, në kushte në të cilat shpesh rrezikohet shëndeti i nënës dhe fëmijës. Për më tepër, këto lindje nuk raportohen në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe të regjistrimit civil. Lindjet e peregjistruara, në kushtet e migrimit apo zhvendosjes jashtë vendit apo në shtetet trashëgimtare të ish-Jugosllavisë, ndihmojnë në shtimin e problemit. Duhet të sigurohen mekanizma konkret që marrin parasysh situatën specifike të

¹² Drafti i datës 29 janar 2007.

¹³ Aktualisht, puna dhe funksionimi i zyrave të regjistrimit të gjendjes civile rregullohet me Ligjin e Kuvendit të Kosovës nr. 2004/46 për Librat Amzë, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/21.

komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas dhe ta trajtojnë atë përmes veprimeve të synuara të institucioneve qendrore dhe komunale, bazuar në bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet sistemit të regjistrimit civil, institucioneve shëndetësore dhe të mirëqenies sociale.

3. Metodologjia

Ky raport përmban gjetjet nga intervistat e zhvilluara nga ekipet komunale të OMiK-ut (EK) nga 11 dhjetori 2006 deri më 15 janar 2007, në 28 komuna, tri pilot-njësi komunale (PNjK) dhe në Gračanica/Gračanicë.¹⁴ Në mënyrë që të vlerësojnë vetëdijesimin dhe të kuptuarit e obligimeve sipas rekomandimeve të ZKM-së¹⁵ dhe vullnetit për të miratuar procedura fleksibile për regjistrimin e aplikantëve romë, ashkali dhe egjiptas. Ekipet komunale të OMiK-ut intervistuan zyrtarë gjegjës komunalë.

Në veçanti, EK-të intervistuan përfaqësues të institucioneve komunale me përgjegjësi të drejtpërdrejt për regjistrimin e banorëve të përhershëm, QKRC-të, si dhe institucionet përgjegjëse për regjistrimin e gjendjes civile, ZKGjC-të. Ata gjithashtu kanë kontaktuar me spitalet rajonale lidhur me procedurat dhe certifikatat e lëshuara për të vërtetuar lindjet në spitale, si pjesë e procesit të regjistrimit të gjendjes civile. Ndër të tjera, ata kanë intervistuar zyrtarë të tjerë komunalë që nuk janë drejtpërdrejtë përgjegjës për regjistrimin civil, por që janë përgjegjës për komunitetet siç janë zyrat komunale për komunitete (ZKK) dhe çështje të kthimit, zyrtarët komunalë për kthim. EK-të gjithashtu kanë kontaktuar me zyrat e UNHCR-së në terren, PDCK-në dhe përfaqësuesit vendorë të DAC-it të UNMIK-ut. Duke u nisur nga fakti se, në kuadër të fushatës së përmendur, PDCK-ja ishte drejtpërdrejt përgjegjëse për të kontaktuar me komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase dhe t'u ofrojë atyre asistencë për regjistrim civil, EK-të e OMiK-ut nuk iu janë qasur drejtpërsëdrejti komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase.

4. Niveli i njohjes së Rekomandimeve të ZKM-së përkitazi me regjistrimin civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve

Në nenin 3(c) të Rekomandimeve të ZKM-së thuhet: “duke njohur faktin se ekziston një numër kërkesash të pazgjdhura për dokumentacion të regjistrimit civil, komunat udhëzohen të sigurojnë që kërkesat e pazgjdhura për regjistrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të përfundojnë në gjashtë muajt e ardhshëm. Ndaj këtyre grupeve, nuk zbatohen pagesat e vonuara për këto shërbime administrative.”

Shumica e zyrtarëve të intervistuar të ZKGjC-së, QKRC-së, ZKK-së dhe atyre për kthim kanë deklaruar se nuk i kanë marrë ato apo nuk kishin dijeni për përmbajtjen e tyre. Siç shihet në tabelën 1, vetëm një zyrtar i QKRC-së¹⁶ (3.7%), pesë zyrtarë të ZKGjC-së¹⁷

¹⁴ Shih Shtojcën 1 në fund të këtij raporti. Gračanica/Gračanica nuk është PNjK, por ka disa nga zyrat dhe shërbimin administrativ që janë trajtuar si temë në këtë raport.

¹⁵ Të procesojë në mënyrë të duhur aplikacionet e reja dhe ato në pritje nga komunitetet RAE dhe të sigurojë që kjo kategori e aplikantëve të lirohet nga pagesa e tarifave.

¹⁶ Obiliq/Obilić. Zyrtari i përfshirë ka thënë se UNHCR-ja, DAC-i i UNMIK-u dhe OJQ-të i kanë ofruar udhëzime të përgjithshme dhe asistencë komunës në zbatimin e Rekomandimeve duke iu referuar në mënyrë të posaçme qendrës kolektive të komunitetit RAE në Plementinë/Plementina.

(16.7%), tre zyrtarë të ZKK-së¹⁸ (12.5%), dhe katër zyrtarë komunalë për kthim¹⁹ (15.4%) kanë thënë se u janë shpërndarë Rekomandimet.

Tabela 1: “A e keni marrë kopjen e rekomandimeve të ZKM-së lidhur me azhurnimin e politikave dhe procedurave për kthim?”

Institucioni	QKRC		ZKGjC		ZKK		Zyrtari komunal për kthim	
		%		%		%		%
Po	1	3.7	5	16.7	3	12.5	4	15.4
Jo	26	96.3	25	83.3	21	87.5	22	84.6
Nën-totali⁽¹⁾	27	100	30	100	24	100	26	100
n/z⁽²⁾	5	/	2	/	8	/	6	/
Totali	32	/	32	/	32	/	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë përlogariten duke iu referuar vetëm institucioneve për të cilat janë dhënë përqindje; (2) n/z do të thotë se përgjigja nuk është dhënë apo që pyetja nuk është parashtruar.

Ngjashëm, vetëm një numër i kufizuar i zyrtarëve të intervistuar kanë deklaruar që janë të njohur me përmbajtjen e Rekomandimeve: dy²⁰ QKRC-të (7.1%); gjashtë²¹ ZKGjC-të (20%); tri²² ZKK-të (11.5%); dhe katër zyrtarët komunalë të kthimit²³ (14.3%).

Tabela 2: “A është zyrtari i intervistuar i njohur me përmbajtjen e "Rekomandimeve"?”

Institucioni	QKRC		ZKGjC		ZKK		Zyrtari komunal për kthim	
		%		%		%		%
Po	2	7.1	6	20	3	11.5	4	14.3
Jo	26	92.9	24	80	23	88.5	24	85.7
Nën-totali⁽¹⁾	28	100	30	100	26	100	28	100
n/z⁽²⁾	4	/	2	/	6	/	4	/
Totali	32	/	32	/	32	/	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë përlogariten duke iu referuar vetëm institucioneve për të cilat janë dhënë përqindje; (2) n/z do të thotë se përgjigja nuk është dhënë apo që pyetja nuk është parashtruar.

Mirëpo, në së paku dy komuna,²⁴ drejtorët e Departamentit të Administratës së Përgjithshme kanë konfirmuar që Rekomandimet u janë shpërndarë të gjitha zyrave komunale. Siç kanë konfirmuar UNHCR-ja dhe PDCK-ja, në pesë komuna në rajonin e Pejës përfshirë edhe Komunën e Gjakovës/Đakovica,²⁵ PDCK-ja u kishte shpërndarë

¹⁷ ZKGjC-të në Kaçanik/Kaçanik, Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić, Lipjan /Lipljan dhe Podujevë /Podujevo.

¹⁸ ZKK-të në Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić dhe Skenderaj/Srbica.

¹⁹ Zyrtarët komunalë për kthim në Ferizaj /Uroševac, Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić dhe Vushtri/Vučitrn.

²⁰ Obiliq/Obilić dhe Mitrovicë/Mitrovica.

²¹ Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo dhe Mitrovicë/Mitrovica.

²² Obiliq/Obilić, Shtime/Štimlje dhe Ferizaj/Uroševac. ZKK-ja në Ferizaj/Uroševac kishte deklaruar që ishte e njohur me Rekomandimet sa i përket regjistrimit civil për komunitetin RAE.

²³ Ferizaj/Uroševac, Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić dhe Vushtri/Vučitrn.

²⁴ Në Kamenicë/Kamenica, Drejtori i Departamentit të Administratës së Përgjithshme deklaroi se të gjitha zyrat komunale i kanë marrë Rekomandimet. Në Štrpcë/Shtërpçë, kjo është konfirmuar nga PDCK-ja bazuar në kontaktet e tyre me Drejtorin e Departamentit të Administratës së Përgjithshme.

²⁵ Pejë/Peć, Gjakovë/Đakovica, Klinë/Klina, Istog/Istok dhe Deçan/Dečane.

personalisht kopjet e Rekomandimeve QKRC-ve, ZKK-ve dhe zyrtarëve komunalë për kthim. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, UNHCR-ja dhe PDCK-ja u kishin dërguar kopjet e Rekomandimeve të gjitha komunave²⁶, por ato i kanë refuzuar sepse ato nuk i kishin vullat zyrtare²⁷. Në të dy rastet, fakti që Rekomandimet janë shpërndarë nga një organizatë e jashtme dhe jo përmes kanaleve hierarkike të IPVQ-ve kishin rezultuar në situatën që zyrtarët komunal nuk i kanë marrë me seriozitet ato, madje edhe kanë refuzuar t'i pranojnë ato. Deklarata e ZKGjC-së në Ferizaj/Uroševac se respekton vetëm ato udhëzime që vijnë nga Drejtori i Administratës së Përgjithshme pasqyron rëndësinë që të sigurohet se të gjitha politikat shpërndahen përmes vijave përkatëse hierarkike derisa të arrijnë tek zyrtari implementues.²⁸

Për më tepër, fakti që Rekomandimet nuk janë ligjërisht të detyrueshme kontribuon më tej në shfaqjen e veprimeve mospërfillëse të zyrtarëve implementues²⁹. Në Klinë/Klina, zyrtarët e intervistuar të QKRC-së dhe ZKGjC-së kanë deklaruar se ata respektojnë vetëm ligjin e zbatueshëm. Kjo konfirmon nevojën për udhëzime specifike të IPVQ-ve që definojnë çfarëdo mase të posaçme, iniciativë apo fushatë që është po aq në përputhshmëri me ligjin e zbatueshëm. Këto udhëzime duhet të përcaktojnë saktë hapat që duhet respektuar gjatë zbatimit të masave në rrethana specifike për të mirën e një grupi të synuar specifik dhe brenda një kornize të caktuar kohore.

IPVQ-të qendrore janë përgjegjëse për të siguruar që politikat e tyre të jenë të shpërndara në mënyrë të duhur në tërë administratën publike, duke përfshirë komunitat.

Në këtë rast, shumica dërmuese e zyrtarëve të intervistuar kanë pohuar që nuk janë në dijeni të ndonjë politike të IPVQ-ve qendrore që synon lehtësimin e regjistrimit civil të pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Kjo ndodh me gjithë faktin se Rekomandimet janë të përshkruara në mënyrë të qartë në Doracakun e rishikuar për kthim të qëndrueshëm të UNMIK-ut/IPVQ-ve.³⁰ Kryetarët e kuvendëve komunale (KKK-të) në tërë Kosovën kryesojnë grupet punuese komunale për kthim (GPKK), procedurat e të cilave janë të përshkruara në këtë doracak. Kryeshefat ekzekutivë (KShE-të) dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve (BD) marrin pjesë në këto grupe punuese dhe pritjet që të shpërndajnë Doracakun dhe dokumentet e tjera përkatëse të GPKK-ve brenda departamenteve të tyre përkatëse.

²⁶Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zvečan, Zubin Potok/Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitër. Ky raport i OMiK-ut nuk përmban informata lidhur me Komunën e Zubin Potokut/Zubin Potok.

²⁷Informacioni i është dhënë EK-së së OMiK-ut në Mitrovicë/Mitrovica.

²⁸Gjatë diskutimeve me EK-të e OMiK-ut në Pejë/Peć, Klinë/Klina, Gjakovë/Đakovica, UNHCR-ja dhe PDCK-ja kanë konfirmuar që, në rast të regjistrimit civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, fakti që Rekomandimet nuk po vinin nga autoriteti i drejtëpërdrejtë ka kontribuar në mospërfilljen e tyre nga institucionet pranuese.

²⁹Kjo analizë është konfirmuar me diskutimet e EK-ve të OMiK-ut në Gjakovë/Đakovica dhe Klinë/Klina me UNHCR-në dhe PDCK-në.

³⁰Rekomandimet gjenden në faqen 43 të Doracakut. Doracaku është në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze.

Implementimi i çfarëdo rekomandimi, posaçërisht të atyre që kanë nevojë për masa të përkohshme të jashtëzakonshme që nuk janë paraparë me ligj, por që mund të sigurohen vetëm përmes udhëzimeve të qarta me shkrim të lëshuara nga IPVQ-të qendrore dhe që ato të shpërndahen tek të gjitha institucionet përkatëse komunale. Ideale do të ishte që udhëzimet e tilla të përmbanin procedura të qarta dhe që në to të përcaktoheshin përgjegjësitë për sigurimin e qasjes së lehtësuar në regjistrim civil për pjesëtarët e komuniteteve romë ashkali dhe egjiptianë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Fatkeqësisht, miratimi i udhëzimeve të tilla të IPVQ-ve qendrore ka mbetur pezull në rastin e regjistrimit civil për pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Një nga zyrtarët e intervistuar,³¹ i cili dukej se kishte njohuri të mira për Rekomandimet, ka theksuar se implementimi i tyre ishte i vështirë sepse nuk ishin specifike dhe nuk i kanë definuar qartë masat dhe as nuk i kanë përcaktuar kompetencat. Njëkohësisht, regjistrimi i kandidatëve romë, ashkali dhe egjiptianë ishte më i vështirë për shkak mungesës së madhe të dokumentacioneve dhe rasteve të shpeshta të analfabetizmit, madje në disa raste aplikantët nuk e dinin as datën e lindjes së tyre.

5. Tarifat e regjistrimit civil

5.1. Çmimi dhe mundësia e pagimit të tarifave komunale

Legjislacioni i zbatueshëm në Kosovë u jep kuvendeve komunale autoritetin e përcaktimit të nivelit dhe të llojit të tarifave që aplikohen për shërbimet e tyre të regjistrimit të gjendjes civile.³² Kjo ka çuar në dallime të dukshme në tarifat administrative të kërkuara nga komunat. Prandaj, banorët e komunave të ndryshme u nënshtrohen tarifave të ndryshme për të njëjtin lloj të shërbimit. Në bazë të informatave të mbledhura nga EK-të e OMiK-ut, tarifat për lëshimin e certifikatave të lindjes³³ ndryshojnë prej 0.50 deri në 2.00 €. Dallimet janë edhe më të mëdha për llojet e tjera të certifikatave të gjendjes civile, siç shihet në tabelën 3 më poshtë.

Tabela 3: Tarifat komunale që aplikohen në lëshimin e certifikatave të ndryshme të gjendjes civile.

Certifikata	Gama e çmimeve * (€)	Dallimi maksimal në çmim *(€)	Dallimi maksimal në çmim %
Martesore	0.50 – 10.00	9.50	1900%
Ndryshimet në certifikata	0.50 – 10.00	9.50	1900%
Gjendja martesore	1.00 – 10.00	9.00	900%
Zëvendësimet në bazë të arkivave të regjistrimit	0 (dhe 0.50) – 8.00	(7.50)	(1500%)
Vendimi për lejimin e regjistrimit në librat amzë të	0 (dhe 0.50) – 6.00	(5.50)	(1100%)

³¹ ZKGjC-ja në Podujevë/Podujevo.

³² Në pajtim me nenin 4.12 të Ligjit nr. 2004/46 të Kuvendit të Kosovës mbi Regjistrat e Gjendjes Civile, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/21: “Lloji dhe lartësia e taksës administrative për regjistrimin e fakteve caktohet nga kuvendi komunal në bazë të këtij ligji”.

³³ Prizreni dhe Mamuşa/Mamusha/Mamuşa e kanë tarifën më të ulët - 0.5 €. Njëzet komuna zbatojnë tarifën prej 1 €. Në dy komuna (Gjilan/Gnjilane dhe Deçan/Deçane), si dhe një PNJK (Junik) tarifa është 1.5 €. Tarifa më e lartë aplikohet në Skenderaj/Srbica dhe Istog/Istok - 2 €. Derisa këto mund të duken dallime të vogla në të holla, ekziston dallimi në masën 300% mes tarifës më të ulët dhe asaj më të lartë.

lindjes			
Certifikatë e vdekjes	0.50 – 5.00	4.50	900%
Vërtetimi që personi është gjallë	1.00 – 10.00	9.00	900%
Deklarata e dëshmitarit	0 (dhe 0.50) – 2.50	(2.00)	(400%)
Deklarata mbi pranimin e atësisë/amësisë	0 (dhe 1.00) – 5.00	(4.00)	(400%)

Megjithëse janë futur në përdorim në pajtim me ligjin, në disa raste dallimet në çmime mes tarifave komunale kanë arritur masa të tepruara³⁴ dhe kanë vënë banorët e disa komunave në një disavantazh të veçantë. Ka mundësi që dallimet e tilla të tepruara mes praktikave komunale kundrejt të drejtave themelore mund të rezultojnë në ndonjë formë të diskriminimit të tërthortë.³⁵ Synimi i tarifave të tilla duket legjitim. Megjithatë, mënyra e arritjes së një synimi të tillë mund të merret si e papërshtatshme, e panevojshme dhe jo proporcionale në rastet kur komunat e veçanta kërkojnë nga banorët tarifa katër deri në njëzet herë më të larta sesa tarifa më e ulët e aplikuar në komunat e tjera për të njëjtin shërbim të gjendjes civile.

Institucionet shëndetësore në të cilat lindin foshnjat janë përgjegjëse për njoftimin e këtyre fakteve tek ZKGjC-të përgjegjëse dhe për lëshimin e certifikatës së lindjes në spital për prindërit. Të dyja dokumentet janë të nevojshme për regjistrimin e foshnjës së porsalindur në regjistrin e gjendjes civile. Në përgjithësi, spitalet rajonale apo klinikat komunale për lindje nuk kërkojnë pagesa për lëshimin e certifikatës që konfirmon lindjen në spital/klinikë. Njëkohësisht, participimet janë të domosdoshme në disa komuna, me pagesat që sillen prej 1.00³⁶ deri 1.50,³⁷ 2.50³⁸ dhe 5.00 €³⁹. Me pak përjashtime,⁴⁰ spitalet rajonale apo klinikat komunale për lindje nuk aplikojnë tarifa për dokumentet e lëshimit nga spitali. Dallimet më të mëdha në çmime sillen prej 200% për tarifën e lëshimit nga spitali deri në 400% për tarifën e participimit, për lëshimin e certifikatës për konfirmimin e lindjes në spital.

Tabela 4: Tarifat e spitaleve për certifikatat e nevojshme për qëllime të gjendjes civile.

Certifikata	Gama e çmimeve (€)	Dallimi më i madh në çmim në €	Dallimi më i madh në çmim në %
-------------	--------------------	--------------------------------	--------------------------------

³⁴ Lista e tarifave për këto shërbime sipas komunave mund të gjendet në Shtojcën 2, në fund të raportit.

³⁵ Në pajtim me Ligjin e Kuvendit të Kosovës nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit (LKD), i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32: “Diskriminimi i tërthortë nënkuptohet kur nga bazat e përshtatshme nën 2 (a), një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në shikim të parë e vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, duke u bazuar në një apo më shumë baza që e ndalojnë diskriminim, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në mënyrë objektive me një qëllim legjitim dhe me mjete legjitime, të përshtatshme dhe të domosdoshme për arritjen e qëllimit (neni 3, b). Në bazë të parimit të “trajtimit të barabartë”, LKD-ja ndalon të gjitha format e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë “ndaj personit(ave), në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera” (neni 2, pika a).

³⁶ Viti/Vitina, Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Prishtinë/Priština.

³⁷ Istog/Istok.

³⁸ Zvečan/Zvečan dhe Leposaviq/Leposavić.

³⁹ Kamenicë/Kamenica, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn.

⁴⁰ Në lirimet nga pagesa e tarifës të raportuara nga EK-të e OMik-ut hyjnë Spitali Rajonal në Gjilan/Gnjilane (3 €) dhe klinikat e maternitetit në Shtime/Štimlje dhe Viti/Vitina (1 €).

Dokumentet për lëshimin nga spitali	0 (1.00) – 3.00	(2.00)	(200%)
Tarifat e participimit për lëshimin e certifikatës që vërteton se personi ka lindur në spital	0 (dhe 1.00) – 5.00	(4.00)	(400%)

Duke iu referuar regjistrimit civil të banorëve të përhershëm, vetëm lëshimi i letërnjoftimeve është pa pagesë. Përndryshe, aplikohen tarifa prej 15 deri 20 € në rast të zëvendësimit të letërnjoftimit të humbur ose të dëmtuar (15 €), ndërrimit të fotografisë (20 €), apo korrigjimit të të dhënave (20 €). Lëshimi i dokumenteve të udhëtimit u nënshtrohet tarifave të larta për kërkimin, përtërirjen, lëshimin e kopjes, ndërrimin e fotografisë, korrigjimin, zëvendësimin në rast të humbjes apo dëmtimit (31 € në të gjitha rastet), ndërkaq vazhdimi i afatit të tyre kushton (15 €).⁴¹

5.2. Lirimi nga pagesat e tarifave komunale

Praktikat në komuna përkitazi me lirimin nga tarifat e regjistrimit në gjendjen civile dallojnë në masë të madhe. Njëzetë e tri⁴² (76.7%) ZKGjC lirojnë kategori të ndryshme të personave, ndërsa shtatë të tjerat⁴³ (23.3%) nuk zbatojnë kurrfarë lirimi.

Tabela 5: Lirimet nga tarifat që zbatohen nga ZKGjC-të

Grupet përfituese	Numri i ZKGjC-ve	%
Përfituesit nga skema e asistencës sociale	19	63.3
Familjet e dëshmorëve	12	40
Invalidët e luftës	8	26.7
Romët, ashkalitë dhe egjiptianët ⁽⁴⁾	5	16.7
Studentët	3	10
Pensionistët/pleqtë	2	9
PAK-të ⁽³⁾	2	9
Minoritetet	1	3.3
Fëmijët	1	3.3
Gratë shtatzëna	1	3.3
Nuk ka lirime	7	23.3
Nën-totali ⁽¹⁾	30	100
n/z ⁽²⁾	2	/
Gjithsej	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë përlogariten me një referencë të vetme në institucionet që ofrojnë përgjigje; (2) n/z do të thotë që ose nuk ofrohet përgjigje ose pyetja nuk zbatohet; (3) Raportohet që në Shtimje/Štimlje, vetëm ata PAK-ë që janë edhe anëtarë të OJQ-së Handikos përfitojnë nga lirimi nga pagesa; (4) Përveç ZKGjC-ve në Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo, Mitrovicë/Mitrovica,

⁴¹ Informata të siguruar me dashamirësi për EK-të e OMiK-ut nga QKRC-ja në Obiliq/Obilić.

⁴² PNjK-të Gračanica/Gračanicë, Han i Elezit/Đeneral Janković dhe 22 komuna: Ferizaj/Uroševac, Gjiilan/Gnjilane, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Shtërpçë/Štrpce, Viti/Vitina, Malishevë/Mališevo, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Deçan/Deçane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Zveçan/Zvečan, Vushtrri/Vučitrn.

⁴³ Novobërdë/Novo Brdo (ndonëse EK-ja është në dijeni për vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv mbi lirimin e pjesëtarëve të komunitetit RAE nga pagesa e tarifave për regjistrim civil), Prizren (raportohet se kjo është për shkak të udhëzimeve nga niveli qendror), Gjakovë/Đakovica (një praktikë e re; ndërsa më parë ishin liruuar kategori të ndryshme), Obiliq/Obilić (për shkak se tarifat që aplikohen janë të ulëta), Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Leposavić/Leposaviq (në bazë të legjisllacionit të Republikës së Serbisë) dhe PNjK-ja Mamuşa/Mamushë/Mamuša.

Zvečan/Zvečan edhe struktura paralele e vendosur në veriun e Mitrovicës/Mitrovica gjithashtu i liron romët, ashkallitë dhe egjiptianët nga këto tarifa.

Vetëm pesë ZKGjC⁴⁴ (16.7%) kanë deklaruar një praktikë të lirimit të pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, ashtu siç kërkohet nga rekomandimet e ZKM-së. Zyrtarët e një ZKGjC-je⁴⁵ tjetër kanë deklaruar se ata i lejojnë lirimet nga tarifat për pjesëtarët e komuniteteve minoritare. Siç duket, pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë lirohen nga pagesa e tarifave në gjashtë prej 30 komunave (20% e të gjitha komunave). Zbatimi i këtyre lirimeve nga pagesa e tarifave në rastet individuale mund t'i nënshtrohet një shkalle të caktuar të diskrecionit, atëherë kur autoritetet komunale duhet të vendosin nëse një aplikant ka të drejtë për këtë në bazë të komunitetit që i takon. Disponueshmëria dhe mundësia e qasjes në informim adekuat publik lidhur me kategoritë që lirohen nga pagesa e tarifave, kriteret e lirimit dhe procedurat mund të kontribuojnë në zvogëlimin e këtyre dykuptimësive.

Në tri komuna, lirimi i pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë nga pagesa e tarifave të gjendjes civile ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve gojore⁴⁶ ose i memorandumëve të mirëkuptimit⁴⁷ (MiM) ndërmjet PDCK-së dhe komunave. ZKGjC-ja në Lipjan/Lipljan i zbaton këto lirime nga pagesa e tarifave vetëm në rastet kur aplikanti ndihmohet nga PDCK-ja dhe ka raportuar se në vitin 2006, në këtë mënyrë, pesëmbëdhjetë aplikantë romë, ashkali dhe egjiptianë janë liruar nga pagesa e tarifave për regjistrim në statusin civil. Në dy komunat e tjera⁴⁸, zyrtarët e ZKGjC-së kanë deklaruar se shumica e aplikantëve romë, ashkali dhe egjiptianë janë liruar nga pagesa e tarifave për shkak të gjendjes së tyre të rëndë ekonomike, që me gjasë do të thotë se janë përfitues të regjistruar të asistencës sociale. Rrjedhimisht, në vend se të kishte një politikë të unifikuar qendrore, praktikat dhe aranzhimet lokale që u janë komunikuar zyrtarëve përgjegjës komunalë kanë qenë pikë kthese.

Nëntëmbëdhjetë ZKGjC⁴⁹ (63.3%), kanë deklaruar se kanë pasur një praktikë të lirimit nga pagesa e tarifave të gjithë përfituesit nga skema e asistencës sociale të regjistruar në qendrat komunale për punë sociale (QKPS). Kategoritë në vijim gjithashtu janë liruar nga pagesa e tarifave në komuna të ndryshme, kryesisht në bazë të vendimeve nga KK-të:

- familjet e dëshmorëve (që sipas të gjitha gjasave janë shqiptarë të Kosovës), në dymbëdhjetë⁵⁰ (40%) raste;

⁴⁴ Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo, Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zvečan. Po ashtu, struktura paralele ZKGjC në veri të Mitrovicës/Mitrovica i aplikon këto lirime nga pagesa për komunitetin RAE.

⁴⁵ Viti/Vitina. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë pjesëtarët e komuniteteve RAE.

⁴⁶ Mitrovicë/Mitrovica dhe Zvečan/Zvečan.

⁴⁷ Lipjan/Lipljan.

⁴⁸ Shtime/Štimlje dhe Podujevë/Podujevo.

⁴⁹ Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Shtërpçë/Štrpce, Viti/Vitina, Malishevë/Mališevo, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Deçan/Deçane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Skenderaj/Srbica, Vushtri/Vučitrn dhe PNjK-ja e Hanit të Elezit/Đeneral Janković.

⁵⁰ Gjilan/Gnjilane, Kaçanik/Kaçanik, Shtime/Štimlje, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Deçan/Deçane, Istog/Istok, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Vushtri/Vučitrn dhe PNjK-ja e Hanit të Elezit/Đeneral Janković.

- invalidët e luftës dhe familjet e tyre, në tetë⁵¹ (26.7%) raste;
- studentët, në tri⁵² (10%) raste;
- fëmijët,⁵³ personat me aftësi të kufizuara (PAK),⁵⁴ pensionistët,⁵⁵ të vejat si pasojë e luftës të cilat janë kryefamiljare⁵⁶ dhe veteranët e luftës⁵⁷ në dy (6.7%) raste;
- gratë shtatzëna,⁵⁸ minoritetet,⁵⁹ dhe personat e tjerë në gjendje të rëndë,⁶⁰ në një (3.3%) rast.

6. Nismat komunale për lehtësimin e regjistrimit civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve

6.1. Masat lehtësuese

neni 6.1 i Ligjit Kundër Diskriminimit (LKD)⁶¹ të Kuvendit të Kosovës përcakton se “për sigurimin e barazisë së plotë në praktikë, masa për parandalimin apo kompensimin për disavantazhet” që lidhet me një ose më shumë baza të diskriminimit të ndaluar⁶² “nuk konsiderohet diskriminim, me kusht që kjo të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut”.⁶³ LKD-ja i përkufizon këto masa si “veprime pozitive”. Përveç kësaj, Konventa Korniza e Këshillit të Evropës (KE) mbi Pakicat Kombëtare është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë⁶⁴ dhe kërkon që shtetet dhe institucionet që obligohen nga kjo konventë “...të miratojnë, kur është e nevojshme, masa adekuate për të promovuar, në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive mes personave që u takojnë pakicave kombëtare dhe atyre që i takojnë

⁵¹ Gjilan/Gnjilane, Kaçanik/Kaçanik, Shtime/Štimlje, Rahovec/Orahovac, Istog/Istok, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn dhe PNJK-ja e Hanit të Elezit/Đeneral Janković.

⁵² Gjilan/Gnjilane, Suharekë/Suva Reka dhe Istog/Istok.

⁵³ Gjilan/Gnjilane dhe Suharekë/Suva Reka.

⁵⁴ Istog/Istok dhe Shtime/Štimlje (ndonëse në këtë rast, me kufizim vetëm për PAK-të të cilët janë anëtarë të OJQ-së Handikos).

⁵⁵ Istog/Istok dhe Gračanica/Graçanicë.

⁵⁶ Podujevë/Podujevo dhe Prishtinë/Priština.

⁵⁷ Deçan/Dečane dhe Klinë/Klina.

⁵⁸ Gračanica/Graçanicë.

⁵⁹ Viti/Vitina. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë pjesëtarët e komunitetit RAE.

⁶⁰ Viti/Vitina.

⁶¹ Ligji nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit (LKD) i Kuvendit të Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32.

⁶² LKD-ja ndalon të gjitha format e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë “ndaj cilitdo person, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, mendimit apo bindjes politike, përkatësisë etnike, kombit, religjionit apo besimit, racës, përkatësisë sociale, pronës, lindjes ose statuseve tjera” (neni 2, pika a).

⁶³ “Për sigurimin e barazisë së plotë në praktikë, masa për parandalimin apo kompensimin për disavantazhet e lidhura me një ose më shumë baza të dhëna në nenin 2 (a), nuk konsiderohet diskriminim, me kusht që kjo të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut” (neni 6.1 i LKD-së, veprimet pozitive).

⁶⁴ Sipas kreut 3.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë: “Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në: (...) (h) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK)”.

shumicës” dhe “të njohin në mënyrë të duhur kushtet e personave që u takojnë pakicave kombëtare”.⁶⁵ Në këtë pikëpamje, rekomandimet e ZKM-së kanë krijuar një kornizë të politikës së përgjithshme në kuadër të së cilës, komunat mund të marrin masa adekuate ose veprime pozitive për të siguruar regjistrimin civil të personave të padokumentuar që u takojnë komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, duke marrë parasysh kushtet e tyre specifike.

Tabela 6: “A ndërmerr institucioni ndonjë nismë/masë specifike për të lehtësuar regjistrimin civil dhe lëshimin e dokumenteve/certifikatave për pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë?”

	ZKGjC-të	QKRC-të	Komunat/ PNjK-të ³	% ⁽¹⁾
Po	5 (17%)	5 (18%)	18	(58%)
Jo	25(83%)	23 (82%)	13	(42%)
Nën-totali	30(100%)	28(100%)	31	(100%)
n/z ⁽²⁾	2	4	1	/
Totali	32	32	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë janë përlogaritur me referencë të vetme në institucionet të cilat ofrojnë përgjigje; (2) n/z do të thotë që ose nuk ka përgjigje ose pyetja nuk zbatohet; (3) kjo shtyllë pasqyron përgjigjet e QKRC-ve, ZKGjC-ve, ZKK-ve, zyrtarëve komunal të kthimit, UNHCR-së, PDCK-së dhe DAC-it të UNMIK-ut.

Siç paraqitet në tabelën 6, vetëm pesë ZKGjC (17%) dhe pesë QKRC (18%) kanë raportuar se kanë ndërmarrë masa për të lehtësuar regjistrimin civil të aplikantëve romë, ashkali dhe egjiptianë.

Kjo vërteton se shumica e zyrtarëve nuk janë plotësisht në dijeni për rekomandimet e ZKM-së. Po ashtu, kjo ripohon nevojën për të siguruar që ata të udhëzohen për rolin e rëndësishëm të tyre në shterjen e ngarkesave të rasteve për regjistrim civil që kryesisht kanë të bëjnë me komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë si një çështje prioritare. Thjeshtë vetëm zbatimi i procedurave dhe i legjislacionit ekzistues, mund të mos jetë i mjaftueshëm në rastin e personave të padokumentuar të cilët në fakt nuk njihen para ligjit si persona. Të paktën, këtyre zyrtarëve duhet t’u bëhet me dije detyra e tyre për të informuar dhe lehtësuar regjistrimin e aplikantëve ekzistues dhe për të identifikuar personat që kanë nevojë për të kryer regjistrimin civil, duke përfshirë vizitat kontaktuese në terren.

Po ashtu, duke marrë parasysh përgjigjet e ZKK-ve, zyrtarëve komunalë të kthimit dhe përfaqësuesve të UNHCR-së, PDCK-së dhe DAC-it të UNMIK-ut, duket se 18 (58%) komuna⁶⁶ kanë ndërmarrë masa lehtësuese me efekte dhe rëndësi të ndryshme.

⁶⁵ neni 4.2 i KKPK-së.

⁶⁶ Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo, Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zvečan, Viti/Vitina, Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Prizren, Kaçanik/Kaçanik, Gjakovë/Đakovica, Pejë/Peć, Istog/Istok, Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Vushtrri/Vučitrn. Masat lehtësuese nuk zbatohen në 13 komunat e tjera: Gjilan/Gnjilane, Han i Elezit/Đeneral Janković, Novo Brdo/Novobërdë, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Malishevë/Mališevo, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Deçan/Dečane, Junik, Klinë/Klina, Prishtinë/Priština, Skenderaj/Srbica, Leposavić/Leposaviq.

Pavarësisht nga disa përjashtime domethënëse, shumë shpesh këto nisma duket se janë josistematike, ose ndërmerren në baza *ad hoc* dhe reaktive, si reagim ndaj nismave të aktorëve të jashtëm. Po ashtu, ka raste ku qasja ose përgjigjet e institucioneve të ndryshme komunale janë kundërthënëse.

Në Obiliq/Obilić, ZKGjC-ja, QKRC-ja dhe ZKK-ja kanë krijuar një bashkëpunim funksional ndërmjet zyrave të bazuar në aktivitete të rregullta kontaktuese dhe proaktive, posaçërisht për të qenë në harmoni me nevojat e komuniteteve të pikësnyuara romë, ashkali dhe egjiptianë. ZKGjC-ja dhe QKRC-ja kanë ngritur një ekip lëvizës i cili realizon vizita në terren dhe regjistrime në vend të ngjarjes, posaçërisht për romët, ashkalisht dhe egjiptianët e strehuar në qendrën kolektive në Plementina/Plementinë. Në vitin 2004 dhe 2005, QKRC-ja ka zhvilluar fushata e vetëdijesimit të publik për të promovuar qasjen në shërbimet e tyre, përmes fletushkave dhe pllakateve. ZKK-ja ka dy zyrtarë të angazhuar në mënyrë specifike për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe regjistrimin e tyre. Njëri zyrtar viziton vendbanimet e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve dy herë në muaj dhe në mënyrë proaktive i inkurajon banorët për t'u regjistruar. Zyrtari tjetër është caktuar në ZKGjC dhe i ndihmon aplikantët romë, ashkali dhe egjiptianë në përfundimin e procedurave relevante, përfshirë identifikimin e dëshmitarëve për gjetjen e fakteve përkitazi me identitetin e tyre. Kjo praktikë e mirë zbatohet falë ndarjes së resurseve specifike njerëzore (zyrtarëve të angazhuar) dhe financiare (pagave, automjetit, mjeteve buxhetore për nismat e informimit publik).

Lirimi nga pagesa e tarifave

ZKGjC-të në Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo, Mitrovicë/Mitrovica, Zveçan/Zvečan dhe Novobërdë/Novo Brdo i lirojnë pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë nga pagesa e tarifave administrative, të paktën në rastet kur ata ndihmohen PDCK-ja në dorëzimin e aplikacioneve të tyre. Në Viti/Vitina, ZKGjC-ja pohon se ajo i liron të gjithë pjesëtarët e komuniteteve minoritare nga këto tarifa. Në baza individuale, ZKGjC-ja në Fushë Kosovë/Kosovo Polje i liron aplikantët romë, ashkali dhe egjiptianë nga pagesa e tarifave. Ka mundësi që ky lloj fleksibiliteti zbatohet për aplikantët, kushtet e varfërisë së të cilëve janë të dukshme. Në Novo Brdo/Novobërdë, ndonëse me sa duket ekziston vendimi i Kryeshefit Ekzekutiv (KShE) me të cilin personat që u përkasin komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë lirohen nga pagesa e tarifave për regjistrim civil, ZKGjC-ja nuk e zbaton atë.

Ekipet lëvizëse të regjistrimit në vend të ngjarjes

QKRC-ja dhe ZKGjC-ja në Obiliq/Obilić dhe ZKGjC-ja në Shtime/Štimlje⁶⁷ i shfrytëzojnë ekipet lëvizëse dhe zhvillojnë aktivitete të regjistrimit në vend të ngjarjes. Komunitat e tjera kanë ekipe lëvizëse për kontaktim të cilat do të mund të shfrytëzoheshin për këtë qëllim, siç përshkruhet më poshtë në këtë raport.

Kontaktimi, shpërndarja proaktive e informatave dhe e formularëve të aplikimit

ZKK-të në Obiliq/Obilić dhe Lipjan/Lipljan, kanë zyrtarë romë, ashkali dhe egjiptianë në ndërlidhjes të cilët i vizitojnë rregullisht vendbanimet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe në

⁶⁷ Ekipi lëvizës i viziton në veçanti tri fshatra të banuara nga komunitetet romë dhe ashkali: Gjurkoc/Đurkovce, Vojnoc/Vojinovce, Muzeqinë/Mužicane.

mënyrë proaktive i inkurajojnë banorët për t'u regjistruar. Po ashtu, në Lipjan/Ljipljan, ZKK-të kanë ndihmuar PDCK-në dhe UNHCR-në në aktivitetet e tyre të kontaktimit me popullatën përkitazi me regjistrimin civil, përfshirë ndihmën përmes shpërndarjes së formularëve të aplikimit të udhëheqësit e fshatrave⁶⁸. Kjo ka rezultuar në identifikimin e 30 personave të paregjistruar. Në Podujevë/Podujevo, ZKGjC-ja ka angazhuar një punonjës për të vizituar rregullisht vendbanimet e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë për t'u ofruar personave të padokumentuar informata dhe për të promovuar qasjen e tyre për regjistrim në gjendjen civile. Në zonën e përgjegjesisë (ZR) të Prizrenit/Prizren, UNHCR-ja dhe PDCK-ja kanë mbajtur tryeza të rumbullakëta me aktorët relevantë në të gjitha komunat. Në Suharekë/Suva Reka, PDCK-ja dhe KMKN-ja⁶⁹ - agjenci e udhëhequr nga UNHCR-ja, kanë përfshirë ZKGjC-në dhe QKRC-në në një cikël takimesh me udhëheqësit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, në të cilat kanë siguruar informata në lidhje me procesin e regjistrimit civil dhe kriteret për këtë të drejtë. Në Ferizaj/Uroševac ZKK-ja ka ndihmuar aktivitetet e UNHCR-së dhe PDCK-së për të ngritur vetëdijen për regjistrim civil në radhët e komunitetve të përfshira, përmes nën-zyrave të saj të vendosura në vendbanimet e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Sipas UNHCR-së, në Vushtrri/Vučitrn, komuna shfrytëzon vizitat në terren të Grupit Punues Komunal për Kthim (GPK) për t'i adresuar çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Në Gjakovë/Đakovica, PDCK-ja ka realizuar procesin e regjistrimit civil, ndërsa Karitazi Zvicerran dhe GTZ-së⁷⁰ u kanë ndihmuar personave që tashmë kishin kryer regjistrimin që të aplikojnë për ndihmë sociale.

Fushatat e ngritjes së vetëdijesimit

Në vitin 2004 dhe 2005 në Obiliq/Obilić, QKRC-ja ka zhvilluar fushata të vetëdijesimit të publikut për të promovuar qasje në shërbimet e tyre, përmes fletëpalosjeve dhe afisheve. Në Podujevë/Podujevo, zyrtari komunal i kthimit ka ndihmuar në fushatën e vetëdijesimit të realizuar nga komuna në bashkëpunim me udhëheqësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë. Siç raportohet, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë të përfshirë në këtë u përgjigjën pozitivisht dhe u regjistruan në mënyrë të organizuar. Më shumë se 100 aplikues romë, ashkali dhe egjiptianë i morën certifikatat e lindjes, që ua mundësuan atyre të regjistrohen si banorë të përhershëm dhe t'i marrin dokumentet e identifikimit. Në Ferizaj/Uroševac, ZKK-ja ka ndihmuar fushatën e vetëdijesimit të organizuar nga UNCHR-ja dhe PKDC-ja përmes nënzyrave të veta të vendosura në vendbanimet e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Në Vushtrri/Vučitrn, QKRC-ja ka zhvilluar dy fushata të pikësynuara kontaktimi dhe afrimi përmes ekipeve lëvizëse në vitet 2000 dhe 2004⁷¹. Megjithëse nuk ka pasur aktivitete të caktuara kontaktimi,

⁶⁸ Në veçanti në Gadime të Ulët/Donje Gadimlje dhe Dobrajë të Vogël/Mala Dobranja.

⁶⁹ Komisioni Katolik i Migracionit Ndërkombëtar.

⁷⁰ Asociacioni për Bashkëpunim Teknik ('GTZ').

⁷¹ Pas konfliktit, ekipet lëvizëse të QKRC-së kanë shkuar te komunitetet RAE, kanë mbledhur aplikacionet dhe më pas u kanë dorëzuar atyre letërnjoftimet e lëshuara. Komuna e ndërmori këtë iniciativë me vendim të vetin. Në të njëjtën kohë, pas trazirave të marsit 2004, IPVQ-të qendrore kërkuan që QKRC-ja të zhvillojë një raund të ri të vizitave në terren për t'u dhënë letërnjoftimet personave të cilët i kanë humbur ato gjatë ngjarjeve të tilla.

Komuna i shfrytëzon vizitat në terren të GPK-ve mbi kthimin për të trajtuar çështjet që lidhen me regjistrimin civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Në Lipjan/Lipljan, QKRC-ja ka ndërmarrë iniciativat e fundit të kontaktimit në vitin 2002 dhe 2003. Në Prizren, ZKK-ja dhe zyrtari komunal i kthimit kanë marrë pjesë në iniciativa të ndryshme të organizuara nga OJQ-ja lokale "Iniciativa 6" për të ngritur vetëdijesimin mbi regjistrimin civil në kuadër të vendbanimeve të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Po ashtu, në Shtime/Štimlje, ZKK-ja ka ofruar mbështetje ndaj aktiviteteve të kontaktimit të realizuara nga PKDC-ja në kuadër të fushatës së tyre të regjistrimit civil.

Bashkëpunimi me udhëheqësit e komunitetit/zyrtarët e ndërlidhjes/zyrtarët për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë

Në Obiliq/Obilić, ZKK-ja ka caktuar dy zyrtarë që u kushtohen posaçërisht komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe regjistrimit të tyre. Në Podujevë/Podujevo, ZKGjC-ja ka caktuar një anëtar të personelit që t'i vizitojë vendbanimet e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, ndërsa komuna dhe zyrtari komunal i kthimit bashkëpunojnë me udhëheqësit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Në Lipjan/Lipljan, ZKK-ja ka një zyrtar të ndërlidhjes për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë, i cili kryen aktivitetet e kontaktimit.

Ndihmesa në procedurat dhe identifikimin e dëshmitarëve

Njëri nga zyrtarët e ZKK-së në Obiliq/Obilić është i vendosur drejtpërdrejt në ZKGjC dhe u ndihmon aplikuesve në kompletimin e procedurave të regjistrimit të gjendjes civile. ZKK-ja u ndihmon edhe QKRC-së dhe ZKGjC-së në identifikimin e dëshmitarëve për vërtetimin e fakteve lidhur me identitetin e aplikuesve romë, ashkali dhe egjiptianë të cilët nuk kanë dokumente .

Ndihmesa në transport dhe nënzyrat në vendbanimet e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë

ZKK-ja në Ferizaj/Uroševac siguron transportin për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë, të cilët nuk mund ta përballojnë ose nuk janë në gjendje të udhëtojnë deri te ZKGjC-ja dhe QKRC-ja. Ajo i ka nënzyrat e vendosura edhe në vendbanimet romë, ashkali dhe egjiptiane, gjë që u dëshmuar si sistem i dobishëm për mbështetjen e fushatës së regjistrimit civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

Memorandumet e mirëkuptimit me PDCK-në dhe përgjigja ndaj aktiviteteve të regjistrimit civil

Në Rahovec/Orahovac, UNHCR-ja dhe PDCK-ja kanë thënë se komuna e ka mbështetur shumë fushatën e tyre të regjistrimit civil. Në Ferizaj/Uroševac, UNHCR-ja dhe PDCK-ja e kanë lavdëruar ZKGjC-në për gatishmërinë e saj në zgjidhjen e një numri të rasteve të ndërlikuara të regjistrimit civil. Në Kamenicë/Kamenica, siç raportohet QKRC-ja ka filluar të implementojë MiM-in e nënshkruar ndërmjet PDCK-së dhe komunës, por ZKGjC-ja ka pritur udhëzimet e mëtejshme të IPVQ-ve qendrore para se të vepronte në atë mënyrë. Në Komunën e Istogut/Istok, komuna dhe PDCK-ja kanë qenë në procesin e negociimit të një MiM-i të tillë. Pas kryerjes së aktivitetit të monitorimit në të cilin është bazuar ky raport, më 16 shkurt 2007, PDCK-ja njoftoi se kishte nënshkruar memorandume të mirëkuptimit përkitazi me fushatën e regjistrimit civil për romët,

ashkalitë dhe egjiptianët me njëmbëdhjetë komuna: Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Gjiilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Lipjan/Lipljan, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Pejë/Peć dhe Shtime/Štimlje. PDCK-ja pohon se pas nënshkrimit të memorandumeve të tilla të mirëkuptimit, të gjitha komunat e përfshira kanë përshtatur një qasje më fleksibile dhe janë duke i liruar nga tarifa e regjistrimit të gjendjes civile të gjitha rastet që PDCK-ja ua dorëzon atyre. Nëse konfirmohet kjo, atëherë ky zhvillim tregon se një numër gjithnjë në rritje i komunave kanë filluar të ndër marrin masa të konsiderueshme për të lehtësuar regjistrimin civil të pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë: një marrëveshje me shkrim me partnerin implementues të fushatës së regjistrimit civil; lirimi nga tarifa dhe një qasje më fleksibile ashtu siç kërkohet nga Rekomandimet.

Ndihmesa në regjistrim ndaj personave të riatdhesuar

Në Rahovec/Orahovac, zyrtari komunal i kthimit e ka mbështetur regjistrimin civil të familjeve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, të cilat janë riatdhesuar në këtë komunë. Në Pejë/Peć DAC-i i UNMIK-ut ka konfirmuar se ZKK-ja, zyrtari komunal i kthimit, ZKGjC-ja dhe QKRC-ja u kanë ofruar mbështetje të konsiderueshme familjeve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, që janë kthyer ose riatdhesuar kohëve të fundit në këtë komunë. QKRC-ja në mënyrë të përshtatshme e ka kryer regjistrimin e tyre si banorë të përhershëm.

Mbështetja e pamjaftueshme ndaj fushatës së regjistrimit civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve

Në disa komuna, fushata e regjistrimit civil ende nuk ka marrë mbështetje të mjaftueshme. Siç raportohet, në Novobërdë/Novo Brdo, ZKGjC-ja nuk është duke e zbatuar vendimin e kryeshefit ekzekutiv që i liron aplikantët romë, ashkali dhe egjiptianë nga tarifat e regjistrimit civil. QKRC-ja në Gjakovë/Đakovica ka theksuar se për çfarëdo mase të veçantë duhet të vendoset në nivelin qendror të IPVQ-ve, ndërsa ZKGjC mendonte se nuk kërkohet asnjë masë e veçantë.

Pasi që këto komuna nuk po e zbatonin lirimin nga tarifat ashtu siç kërkohet me rekomandime, PDCK-ja përkohësisht po i paguante ato tarifa në emër të aplikuesve romë, ashkali dhe egjiptianë në Deçan/Dečane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Prizren, Rahovec/Orahovac dhe Suharekë/Suva Reka, ndërkaq Karitasi Zvicëran dhe GTZ-ja po e bënin një gjë të tillë në Gjakovë/Đakovica. Ndonëse nga kjo përfitonin drejtpërdrejt aplikantët romë, ashkali dhe egjiptianë, me këtë praktikë komunat diskurajohen sa i përket zbatimit të rekomandimeve të ZKM-së.

ZKK-ja dhe zyrtari komunal i kthimit në Klinë/Klina kanë thënë se ata nuk janë të njohur me gjendjen e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në komunën e tyre, por se ata më shumë përqendrohen në komunitetin serb të Kosovës dhe në kthimin e pjesëtarëve të këtij komuniteti. Në Malishevë/Mališevo, komuna nuk e ka mbështetur fushatën e kontaktit dhe të afrimit me qytetarë të realizuar nga PDCK-ja përmes vizitave derë më derë, shpërndarjes së fletushkave dhe veprimeve të tjera për të rritur vetëdijesimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë sa i përket procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e regjistrimit civil. Në Prizren dhe Malishevë/Mališevo,

QKRC-ja dhe ZKGjC-ja kanë bërë rezistencë përkitazi me miratimin e masave të përkohshme të posaçme për lehtësimin e regjistrimit të personave të padokumentuar romë, ashkali dhe egjiptianë që nuk kishin dokumente.

Në Viti/Vitina, me siguri për shkak të kufizimeve në personel, QKRC-ja e ka ndërprerë praktikën e kryerjes së vizitave në terren përmes ekipeve lëvizëse që kontaktonin me grupet që janë në pozita të pafavorshme dhe e bënin regjistrimin e tyre. Ndër të tjera, EK-ja e OMiK-ut konsideron se zyrtarët e ZKGjC-së dhe zyrtari komunal i kthimit i kuptojnë shumë pak nevojat e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. ZKK-ja i ka vlerësuar negativisht aktivitetet e QKRC-së dhe ka shprehur shqetësimin se legjislacionin në fuqi e pengon regjistrimin e personave me prejardhje nga Kosova, por që nuk kanë dokumente për të dëshmuar identitetin dhe të drejtën e tyre për t'u regjistruar.

6.1.1 Përdorimi i ekipeve lëvizëse të regjistrimit

Vetëm nëntë QKRC⁷² (33%) dhe dhjetë ZKGjC⁷³ (37%) kanë ekipe lëvizëse që janë përdorur ose që mund të përdoren për të arritur deri te grupet e cënueshme, për të kryer regjistrimin civil jashtë zyrave të tyre.

Tabela 7: “A po i përdorin QKRC-të dhe ZKGjC-të ekipet lëvizëse për të arritur deri te komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë?”

Përdorimi i ekipeve lëvizëse?	QKRC	% ⁽¹⁾	ZKGjC	% ⁽¹⁾
Po	9	33	10	37
Jo	18	67	17	63
Nën-totali	27	100	27	100
N/z ⁽²⁾	5	/	5	/
Totali	32	/	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë janë përlogaritur me të vetmen referencë në institucionet për të cilat ka pasur përgjigje; (2) N/Z d.m.th se ose nuk ka pasur përgjigje ose pyetja nuk është e aplikueshme.

Në këtë aspekt, fushata e UNHCR-it është duke e zëvendësuar veprimin e kufizuar ose mungesën e veprimit nga autoritetet gjegjëse, që në shumicën e rasteve dështojnë në marrjen e përgjegjësive për të kontaktuar dhe për t'u afruar me personat e padokumentuar romë, ashkali dhe egjiptianë dhe nuk ndërmarrin veprime për të parandaluar përjashtimin e tyre qytetar, si dhe pamundësinë e tyre për t'i ushtruar të drejtat dhe obligimet e tyre.

Madje edhe në komunat të cilat dërgojnë ekipe lëvizëse në terren, aktiviteti i tillë në përgjithësi është i kufizuar në fushëveprim dhe rrallëherë i synon komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe nevojat e tyre specifike. Në Pejë/Peć, Gjakovë/Đakovica, Prizren dhe Lipjan/Lipljan, QKRC-të ose ZKGjC-të përdorin regjistrimin me shkuarje në terren vetëm në baza reaktive, plotësuese, *ad hoc* kur ka ndonjë kërkesë specifike nga personat me aftësi të kufizuara (PAK) ose që përndryshe fizikisht nuk kanë mundësi të shkojnë në QKRC dhe ZKGjC. Përkundrazi, QKRC-të dhe ZKGjC-të në Obiliq/Obilić,

⁷² Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Gjakovë/Đakovica, Prizren, Rahovec/Orahovac, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić, Prishtinë/Priština dhe Zvečan/Zvečan.

⁷³ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Gjakovë/Đakovica, Prizren, Rahovec/Orahovac, Deçan/Dečane, Obiliq/Obilić, Prishtinë/Priština, Zvečan/Zvečan dhe PNjK e Hanit të Elezit/Đeneral Janković.

Zvečan/Zvečan, Mitrovicën Veriore/Severna Mitrovica dhe Prishtinë/Priština kanë vendosur një praktikë të mirë nëpërmjet së cilës, ekipet lëvizëse ofronin shërbime kontaktimi të regjistrimit civil për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, UNHCR-ja dhe PDCK-ja asnjëherë nuk e kanë parë në veprim ekipin lëvizës të regjistrimit civil që siç pretendohet nga komuna, është vënë në funksion. Përkundrazi, ata kanë vërejtur se disa ZKK po e përdorin personelin e tyre për të kontaktuar dhe afruar me komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në mënyrë më konsekuente dhe më depërtuese se institucionet që janë përgjegjëse për regjistrimin civil. Ngjashëm me këtë, ZKK-ja në Pejë/Peć ka vënë re se në të kaluarën ajo ka ndërmarrë një iniciativë për t'i identifikuar pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë për nevoja të regjistrimit civil dhe i ka drejtuar ata për te ZKGjC-ja. Përkundrazi, ZKGjC-ja nuk dukej se i kishte përdorur ekipet lëvizëse për këtë qëllim.

QKRC-ja në Deçan/Dečane e kishte arsyetuar mosvazhdimësinë e ekipit të saj lëvizës me mungesën e veturës, ndërsa QKRC-ja në Lipjan/Lipljan kishte deklaruar se burimet e pamjaftueshme financiare e kishin kufizuar përdorimin e ekipeve lëvizëse vetëm për PAK-ët. Ngjashëm, në Mitrovicën Jugore/Juzna Mitrovica, komuna kishte konkluduar se propozimi i Njësisë për Mbrojtjen Ligjore të Mëhallës Rome për përdorimin e ekipeve lëvizëse të regjistrimit nuk është i realizueshëm për shkak të problemeve logjistike dhe mungesës së burimeve njerëzore. Njëkohësisht, rastet e Prizrenit dhe të Rahovecit/Orahovac demonstrojnë se edhe kur ofrohet ndihma e jashtme, komunat e përfshira në këtë, nuk tregojnë gjithmonë interes për ta shfrytëzuar atë, ose e shfrytëzojnë në masë të kufizuar. Kjo i referohet saktësisht ofertës së përhershme të UNHCR-së për mbështetjen e aktiviteteve të regjistrimit të ekipeve lëvizëse të komunës, përmes transportit dhe ndihmesës tjetër logjistike.

Në Kaçanik/Kaçanik dhe Klinë/Klina,⁷⁴ QKRC-ja dhe ZKGjC-ja shprehimisht kanë deklaruar se nuk kanë patur ekipe lëvizëse për të kontaktuar dhe afruar me komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë, ku deri më tani nuk është regjistruar asnjë kërkesë për regjistrim civil në Komunë e Kaçanikut/Kaçanik. Në Malishevë/Mališevo, Novobërdë/Novo Brdo dhe Štrpce/Shtërpçë, zyrtarët e intervistuar kanë konstatuar se nuk ka pasur nevojë për ekipe të tilla lëvizëse. Në Shtime/Štimlje, kjo praktikë ishte zbatuar në të kaluarën, por nuk ishte vazhduar. Ndonëse, vlerësimi se nuk ka nevojë për aktivitete kontaktuese dhe afruese mund të jetë i saktë në disa raste të caktuara, njohja dhe pranimi publik i çështjes së regjistrimit civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, si dhe marrja përsipër e përgjegjësisë për zgjidhjen e tij mbetet sfidë në disa komuna. Njëkohësisht, është qenësore që IPVQ-të qendrore të kontribuojnë në këtë proces përmes politikave, udhëzimeve dhe resurseve adekuate.

⁷⁴ Kjo ndodh përkundër faktit se në të kaluarën komuna shpesh i kishte përdorur ekipet lëvizëse për kontaktim dhe afrim me komunitetin serb. Kjo qasje ndryshe mund të tregojë se, ose komunitetet RAE konsiderohen më pak të rëndësishme, ose se nuk ka pasur identifikim të nevojës për t'i kontaktuar dhe afruar me ta.

6.1.2 Iniciativat e ZKK-ve dhe zyrtarëve komunalë të kthimit për vetëdijesimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve për regjistrimin civil

Zyrat komunale të komuniteteve (ZKK-të) dhe zyrtarët komunalë të kthimit kanë mandat të caktuar që të sigurojnë që shërbimet dhe politikat komunale të integrohen dhe t'u përgjigjen nevojave të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve, duke përfshirë të kthyerit që banojnë në territorin e komunës së caktuar. Për këtë arsye, dhe duke pasur parasysh cenueshmërinë e pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. EK-të OMiK-ut iu qasën këtyre institucioneve komunale me qëllim që të interesoheshin për angazhimin e tyre në iniciativa për ngritjen e vetëdijesimit të këtyre komuniteteve për rëndësinë e regjistrimit civil.

Tabela 8: “A ka zhvilluar ZKK-ja dhe zyrtari komunal i kthimit aktivitete për të ngritur vetëdijesimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë për rëndësinë e regjistrimit civil?”

Përgjigje	ZKK	% ⁽¹⁾	zyrtari komunal i kthimit	% ⁽¹⁾
Po	5	23	4	16
Jo	17	77	21	84
Nën-totali	22	100	25	100
N/z ⁽²⁾	10	/	7	/
Totali	32	/	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë janë përlogaritur me të vetmen referencë në institucionet për të cilat ka pasur përgjigje; (2) N/z d.m.th se ose nuk ka pasur përgjigje ose pyetja nuk zbatohet.

Mirëpo, përgjigjet e siguruar nga ZKK-të⁷⁵ dhe zyrtarët komunalë të kthimit⁷⁶ tregojnë se përfshirja e tyre në aktivitete për informimin e pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë mbi të drejtat dhe obligimet e tyre lidhur me regjistrimin civil mbetet jashtëzakonisht e kufizuar. Vetëm pesë ZKK-të (23%) dhe katër zyrtarë komunalë të kthimit (16%) kanë thënë shprehimisht se kanë zhvilluar aktivitete në këtë aspekt.

Me gjithë faktin se aktivitetet e kontaktimit dhe të afrimit janë të qenësishme në mandatin e të dyja institucioneve dhe se në ZKK-ja ka të punësuar pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, si dhe ato kanë zyrtarë të ndërlidhjes romë, ashkali dhe egjiptianë, ndërkaq në disa raste kanë të themeluara nënzyrat, që janë të vendosura brenda ose në afërsi të vendbanimeve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë,⁷⁷ ka vend për përmirësim.

⁷⁵ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdë, Shtime/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Prizren, Deçan/Dečane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština, Gračanica/Gračanicë, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Zvečan/Zvečan, Vushtrri/Vučitrn, Leposavić/Leposaviq.

⁷⁶ Gjilan/Gnjilane, Hani i Elezit/Đeneral Janković, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdë, Shtime/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Prizren, Suharekë/Suva Reka, Deçan/Dečane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Gračanica/Gračanicë, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Zvečan/Zvečan, Vushtrri/Vučitrn, Leposavić/Leposaviq.

⁷⁷ Për shembull, kështu ka ndodhur me ZKK-në në Ferizaj/Uroševac.

Megjithatë, ekzistojnë praktikat më të mira, të cilat mund të vihen në zbatim dhe të përsëriten, siç është shembulli i Obiliqit/Obilić i përshkruar më lart.

ZKK-të në Gjakovë/Đakovica dhe në Pejë/Peć kanë deklaruar se ata kishin realizuar vizita kontaktimi dhe afrimi nëpër fshatra, kishin identifikuar persona të peregjistruar, duke përfshirë të kthyerit e kohëve të fundit, dhe i kishin drejtuar ata për te PDCK-ja, respektivisht te ZKGjC-ja. Në Suharekë/Suva Reka, zyrtari komunal i kthimit kishte mbështetur KMKN-në në organizimin e takimeve me komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë për të diskutuar për tema të ndryshme, duke përfshirë regjistrimin civil, regjistrimin e foshnjave të posalindura dhe regjistrimin nëpër shkolla. Po ashtu, DAC-i i UNMIK-ut kishte njohur dhe pranuar faktin se ZKK-ja rregullisht po u siguronte këshilla pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe i drejtonte ata për te institucionet përkatëse.

ZKK-të në Gjakovë/Đakovica dhe Pejë/Peć kanë deklaruar që kanë ndërmarrë vizita nëpër fshatra, kanë identifikuar personat e peregjistruar, duke përfshirë të kthyerit e vonshëm, si dhe i kanë referuar ata tek PDCK-ja, respektivisht ZKGjC-ja. Në Suharekë/Suva Reka, Zyrtari komunal për kthim ka përkrahur KMKN-në në organizimin e takimeve me komunitetin romë, ashkali dhe egjiptianë, për të diskutuar temat e ndryshme, duke përfshirë regjistrimin civil të foshnjeve të posalindura dhe regjistrimin nëpër shkolla. DAC-i i UNMIK-ut gjithashtu ka deklaruar që zyrtari komunal për kthim ka siguruar këshilla të rregullta anëtarëve të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptianë, si dhe ka adresuar ata tek institucionet përkatëse.

Në Lipjan/Lipljan, ZKK-ja ka një zyrtar ndërlidhës për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptianë, i cili bën vizita të rregullta në vendbanimet dhe fshatrat e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Në këtë cilësi, zyrtari ka ofruar informata specifike mbi regjistrimin civil si dhe ka shpërndarë formularët e aplikacioneve të anëtarët e këtyre komuniteteve. Vizita të ngjashme janë bërë edhe nga ZKK-ja dhe zyrtari komunal për kthim në Podujevë/Podujevo.

Në disa komuna, organizata ndërkombëtare dhe vendore janë përfshirë në ngritjen e vetëdijes dhe ofrojnë ndihmë në regjistrimin civil të komunitetit romë, ashkali e egjiptianë, duke përfshirë edhe vizitat derë më derë. Megjithatë, në disa komuna, si për shembull në Klinë/Klina,⁷⁸ ZKK-të dhe zyrtarët komunal për kthim nuk janë të angazhuar dhe nuk kanë një praktikë të tillë, ose thonë që të gjitha aktivitetet e tilla ndërmerren nga agjencitë ndërkombëtare. Kjo ka ndodhur edhe me ZKK-të dhe zyrtarët për kthim në Zvečan/Zvečan dhe Leposavić/Leposaviq.

Një përfshirje e shtuar e institucioneve komunale, duke përfshirë ZKK-të dhe zyrtarët për kthim në fushatë, është thelbësore për qëndrueshmërinë dhe pronësinë e iniciativave të regjistrimit në fund të fushatës aktuale e cila tani për tani është e udhëhequr prej së jashtmi. Kjo duket të jetë e vetmja mënyrë për të siguruar që në të ardhmen, institucionet

⁷⁸ Ndonëse UNCHR-ja dhe PDCK-ja kanë theksuar që këto dy institucione kanë përkrahur shumë fushatën, përgjigjet e tyre duken të tregojnë që ZKK-të dhe zyrtarët e kthimit nuk ndjejnë se janë zotërues të kësaj iniciative.

komunale të identifikojnë në mënyrë aktive personat që kanë nevojë për regjistrim civil, të njohin numrat e tyre dhe gjendjen e tyre specifike, si dhe të ndërmarrin veprime për zgjidhjen e rasteve të tyre, aty ku është e mundur.

6.1.3 Takimet koordinuese të bartësve

Intervistat dhe diskutimet e ekipeve komunale (EK) të Misionit të OSBE-së në Kosovë (OMiK) me QKRC-të, ZKGjC-të, zyrtarët komunal për kthim, UNHCR-në, PDCK-ja dhe DAC-i i UNMIK kanë zbuluar që përgjithësisht nuk ka takime koordinuese komunale nëpër komuna për shkëmbimin e informatave dhe bashkërendimin e veprimeve në mbështetje të fushatës së regjistrimit civil të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptianë. PDCK-ja është i prirur më shumë të takojë institucionet e regjistrimit civil (QKRC-të dhe ZKGjC-të) ndaras, për të diskutuar rastet individuale ose për organizimin e aktiviteteve në terren, shpesh në bashkëpunim me ZKK-të dhe zyrtarët komunal për kthim. PDCK-ja gjithashtu ka nënshkruar MiM-in me komuna të ndryshme, për të konsoliduar bashkëpunimin e tyre me institucionet komunale në fushën e regjistrimit civil.

Këto takime, ose krijimi i ekipeve komunale për zgjidhjen dhe marrjen e iniciativave në lidhje me rastet më të komplikuar të identifikuara gjatë fushatës ishin një nga rezultatet fillestare të parashikuara të fushatës së regjistrimit civil të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptianë. Pavarësisht nga plani fillestar, edhe UNHCR-ja tani duket të favorizojë takimet *ad hoc* të thirrura sipas nevojës, me palë të ndryshme të përfshira.

6.2. Masat e fleksibilitetit

Në pajtim me ligjet e aplikueshme, për t'u regjistruar si banor i përhershëm i Kosovës secili duhet të plotësojë së paku njërin nga kriteret në vijim:

- a) të jetë i lindur në Kosovë;
- b) të ketë së paku njërin prind të lindur në Kosovë;
- c) të ketë banuar në Kosovë për së paku pesë vite në vazhdimësi;
- d) të ketë qenë i detyruar të largohet Kosovën, dhe për këtë arsye nuk ka pasur mundësi të plotësojë kërkesën për banim pesë-vjeçar;
- e) të jetë nën moshën 18-vjeçare, fëmijë pa të drejtë për t'u regjistruar në vartësi nga prindër të regjistruar;
- f) të jetë fëmijë vartës pa të drejtë për t'u regjistruar, mes moshës 18 dhe 23 vjet, i prindërve të regjistruar sipas kriterëve a) deri në d) dhe që vërtetohet se ka patur vijimësi të plotë në një institucion të pranuar arsimor⁷⁹.

⁷⁹ Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil parasheh: "Ofiqari do t'i regjistrojë si banorë të përhershëm personat e poshtëshënuar: (a) Personat e lindur në Kosovë ose ata të cilët e kanë një prind të lindur në Kosovë; (b) Personat të cilët mund të dëshmojnë se kanë banuar në Kosovë për një kohë të pandërprerë prej së paku pesë vitesh; (c) Personat tjerë të cilët, sipas mendimit të ofiqarit, kanë qenë të detyruar të largohen nga Kosova dhe për këtë arsye nuk kanë qenë në gjendje ta plotësojnë kushtin e kohëzgjatjes së banimit në paragrafin (b) të këtij neni dhe (d) Fëmijët e tjerë vartës të personave që nuk e fitojnë të drejtën e regjistrimit sipas nënparagrafëve (a), (b) dhe (c) të këtij

Në secilin nga këto raste zbatohen procedura të ndërlikuara të regjistrimit, ndërsa aftësia e aplikantët që të demonstrojnë identitetin dhe të drejtën e tij/saj varet nga mundësia e paraqitjes së disa dokumenteve. Duke marrë iniciativën e organizimit të fushatës së regjistrimit civil për dobi të personave të padokumentuar të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, UNHCR-ja ka avokuar tek IPVQ-të qendrore për miratimin e masave homogjene komunale të fleksibilitetit me referim ndaj këtyre kërkesave të regjistrimit civil. EK-të e OMiK-ut hulumtuan për ekzistimin e ndonjë praktike të tillë fleksibile komunale, në pritje të miratimit të udhëzimeve të unifikuara nga IPVQ-të qendrore.

6.2.1. Faktet e pranuar nga QKRC-të si provë e zhvendosjes me forcë

Personat që nuk plotësojnë kërkesën e banimit pesë-vjeçar si më lart, përsëri mund të kualifikohen si banorë të përhershëm nëse janë detyruar të ikin dhe për këtë arsye nuk kanë mundur të qëndrojnë në Kosovë për pesë vite pandërprerë. Megjithatë, ata duhet të paraqesin një dokument identifikimi me fotografi,⁸⁰ një kartelë zyrtare të identitetit të refugjatit, vërtetimin për adresën aktuale,⁸¹ si dhe vërtetimin e banimit në Kosovë ose synimit të rikthimit në Kosovë.⁸²

Në rast të zhvendosjes përbrenda vendit, ose të mosposedimit të kartelës së identitetit të refugjatit, aplikantët që janë detyruar të lënë Kosovën mund të përballen me vështirësi serioze në regjistrim nëse nuk kanë mundësi të dokumentojnë bindshëm periudhën e zhvendosjes së tyre. Kështu, secili certifikim i lëshuar nga UNHCR-ja mund të ketë rol kyç për të ndihmuar QKRC-të në formimin e “opinionit” të tyre në lidhje me zhvendosjen e aplikantët. neni 4.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 në të vërtetë i mundëson autoriteteve përgjegjëse të regjistrimit civil të marrin parasysh “...dokumente tjera të lëshuara nga një shtet apo organ i ngjashëm ose nga cilado agjenci e Kombeve të

neni, fëmijët e tillë që janë në moshën 18-vjeçare ose nën moshën 23-vjeçare, por për të cilët dëshmohet se janë vijues të rregullt të një institucioni të pranuar arsimor.”

⁸⁰ Letërnjoftimi i RFJ-së; pasaporta e RFJ-së; indeksi i universitetit; patentë-shoferi i RFJ-së; kartela e identitetit të huaj; pasaporta e huaj, patentë-shoferi e huaj; librezja e gjuetisë; librezja ushtarake; dhe nëse është e përcjellë me dokumente tjera, kartela zyrtare e identitetit të refugjatit, një deklaratë (për personin e lindur pas vitit 1970), një dokument zyrtar i udhëtimit i refugjatit. Këto kërkesa janë theksuar me nenin 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2001/12, si dhe në Broshurën Informuese të Zyrës Qendrore të Regjistrimit Civil të UNMIK-ut për Procedurat e Regjistrimit Civil dhe Dokumentet e Udhëtimit, Shtojca 1, Skema e dokumenteve të pranueshme, tetor 2004 (Broshura ZQRC-së së UNMIK-ut).

⁸¹ Këto prova duhen siguruar përmes së paku njërit nga këto dokumente: faturat e reja të telefonit, energjisë elektrike apo ujit; librezja e regjistrimit të veturës; kartela e mirëqenies sociale; kontrata e qirasë; si dhe deklaratata nën betim në mbështetje të adresës aktuale e lëshuar nga personi nikoqir (Broshura ZQRC-së së UNMIK-ut).

⁸² Synimi i rikthimit në Kosovë duhet vërtetuar përmes njërit nga këto dokumente: dokumenti i gjendjes civile apo dokumente tjera përkatëse që vërtetojnë lidhje të fuqishme familjare në Kosovë (si gjyshërit e aplikantit, prindërit, burri, gruaja, vëllau/vëllezërit), motra(t), fëmija(ët) apo nipat e mbesat që aktualisht jetojnë në Kosovë); dokumenti që vërteton pronësinë mbi pronën e paluajtshme në Kosovë; si dhe certifikatën e vijimësisë nga një institucion arsimor në Kosovë (Broshura e ZQRC-së së UNMIK-ut).

Bashkuara, të mbështetur, po qe nevoja, me dëshmi të konfirmuara qoftë me shkrim apo me gojë”, për të përcaktuar identitetin dhe të drejtën e aplikantëve.⁸³

EK-të e OMiK-ut hulumtuan te QKRC-të fleksibilitetin në pranimin e deklaratave të shkruara të UNHCR-së apo institucioneve komunale si zyrat komunale të komuniteteve apo zyrtarëve të kthimit si prova të mjaftueshme të zhvendosjes. Ato gjithashtu kanë mbledhur vlerësimet e ZKK-ve, zyrtarëve komunal për kthim, UNHCR-së, PDCK-së dhe DAC-i i UNMIK/ në lidhje me praktikat e QKRC-ve.

Tabela 9: “A pranon QKRC-ja letrat e UNHCR-së, ZKK-ve apo zyrtarëve komunal për kthim si prova të mjaftueshme të zhvendosjes kur aplikuesi nuk ka mundësi të përmbushë rregullin 5-vjeçar për shkak se është detyruar të lëshoj Kosovën?”

Përgjigja	QKRC	% ⁽¹⁾
Po	10	43.5
Jo	5	21.7
Rasti nuk ka ndodhur	8	34.8
Nën-totali	23	100
N/z ⁽²⁾	9	/
Totali	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë janë kalkuluar me referimin e vetëm tek institucionet për të cilat ekziston përgjigja; (2) n/z nënkupton që përgjigja nuk ka qenë në dispozicion ose pyetja nuk është e aplikueshme.

Siç shihet në tabelën 9, 43.5% e QKRC-ve⁸⁴ janë përgjigjur që kanë pranuar apo do të pranonin letrat e UNHCR-së ose ZKK-së dhe zyrtarëve komunale të kthimit të cilat tregonin se aplikuesi është detyruar ta lërë Kosovën, dhe që kjo ka qenë arsyeja që personi nuk mund të plotësojë kushtin e banimit pesë-vjeçar. Një numër i konsiderueshëm i QKRC-ve⁸⁵ (34.8%) nuk ishin marrë me raste të tilla deri në atë kohë, ndërsa një përqindje edhe më e vogël e QKRC-ve⁸⁶ (21.7%) kanë deklaruar që nuk do të pranonin letra të tilla, përveç nëse nuk janë të lejuara nga IPVQ-të qendrore.

Praktikat e QKRC-ve në Prizren dhe Deçan/Deçane, të cilat nuk do të pranonin letra të tilla, si dhe Klinës/Klina e cila pranon letrat e tilla vetëm nëse janë të vërtetuara përmes kanaleve zyrtare, janë qartazi në kundërshtim me nenin 4.2, pika (b) e Rregullores së

⁸³ “Identiteti dhe e drejta për regjistrim mund të vërtetohen përmes njëres nga metodat në vijim: (a) një dokument zyrtar i lëshuar nga një Shtet apo organ i tij, duke përfshirë letërnjoftimin, pasaportën apo ndonjë dokument tjetër udhëtimi që përmban fotografinë apo shenjën e gishtit të aplikantët;

(b) Dokumente tjera të lëshuara nga një Shtet apo organ i tij, apo nga ndonjë agjenci apo organ i Kombeve të Bashkuara, të përcjella kur është e nevojshme me prova të pavarura e të konfirmuara, me shkrim apo me gojë; ose

(c) Dokumente tjera të lëshuara para 10 qershorit 1999 nga subjekte tjera, duke përfshirë, por pa u kufizuar në institucione arsimore, shëndetësore, politike dhe fetare, shërbime publike apo organe tjera kuazi-zyrtare, të përcjella me prova të pavarura e të konfirmuara qofshin me shkrim apo me gojë”.

⁸⁴ Gjilan/Gnjilane, Novo Brdo/Novobërdë, Viti/Vitina, Suharekë/Suva Reka, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština, Gračanica/Gračanicë, Vushtrri/Vučitrn.

⁸⁵ Kaçanik/Kaçanik, Štrpce/Shtërpçë, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zvečan, Leposavić/Leposaviq.

⁸⁶ Kamenicë/Kamenica, Prizren, Deçan/Deçane, Klinë/Klina, Skenderaj/Srbica.

UNMIK-ut nr. 2001/13.⁸⁷ QKRC-të në Kamenicë/Kamenica, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë do të kërkonin ndihmë apo udhëzime nga Zyra Qendrore e Regjistrimit Civil, si dhe duken të mos jenë plotësisht të vetëdijshëm për faktin që UNHCR-ja është Agjenci e Kombeve të Bashkuara, dokumentet e të cilës duhen marrë parasysh për qëllimet e regjistrimit të banimit të përhershëm.

UNHCR-ja dhe PDCK-ja kanë nënvizuar praktikën problematike të QKRC-së në Ferizaj/Uroševac, e cila nuk ua njeh plotësimin e kushtit të banimit 5-vjeçar personave që kanë arritur atë pas vitit 1999.⁸⁸

QKRC-ja në Suharekë/Suva Reka pranon dokumentet e lëshuara nga UNHCR-ja dhe IOM-i. QKRC-ja në Lipjan/Lipljan dhe Istog/Istok pranon letrat e lëshuara nga UNHCR-ja dhe ZKK-ja. Në Istog/Istok, edhe QKRC-ja merr parasysh letrat e lëshuara nga Zyrtari i Kthimit. Në Lipjan/Lipljan, Zyra Komunale e Komuniteteve lëshon letra në emër të personave të zhvendosur në Kosovë, ndërsa UNHCR-ja lëshon letra në emër të personave që janë zhvendosur jashtë Kosovës. Në Prishtinë/Priština dhe Gračanica/Gračanicë QKRC-ja pranon dokumentet dhe kartelat e identifikimit të lëshuara nga UNHCR-ja. QKRC-ja në Štrpce/Shtërpçë pranon kartelat e identitetit të lëshuara nga Ministria e Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur e Republikës së Serbisë. QKRC-ja në Suharekë/Suva Reka është mjaft fleksibile dhe pranon edhe dokumentet përcjellëse konfirmuese⁸⁹ si dhe deklaratat e dëshmitarëve për të vërtetuar identitetin dhe të drejtën për t'u regjistruar të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, të ndihmuar nga PDCK-ja. QKRC-ja në Obiliq/Obilić përdor të gjitha procedurat ligjore të parashikuara me ligjet e aplikueshme⁹⁰. Nëse nuk ka në dispozicion dokumente për vërtetimin e banimit, QKRC-ja bashkë me ZKK-në dhe zyrtarin e kthimit i ndihmon aplikantët të identifikojë dy dëshmitarë, të cilët mund të paraqesin një deklaratë mbi banimin e mëparshëm të aplikantët.

⁸⁷ “Identiteti dhe e drejta e regjistrimit mund të vërtetohet me anë të këtyre metodave: (...) (b) Me dokumente të tjera të lëshuara nga një shtet apo organ i ngjashëm ose nga cilado agjenci e Kombeve të Bashkuara, të mbështetur, po qe nevoja, me dëshmi të konfirmuara qoftë me shkrim apo me gojë”.

⁸⁸ Shprehja e dhënë me nenin 3(b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 sipas së cilit “Personat të cilët mund të dëshmojnë se kanë banuar në Kosovë për një kohë të pandërprerë prej së paku pesë vitesh” kanë të drejtë të regjistrohen si banorë permanentë të Kosovës, nuk paragjykon regjistrimin e personave që kanë plotësuar një dispozitë të tillë para vitit 1999.

⁸⁹ Në bazë të nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13, pika (c), përveç dokumenteve tjera me fotografi të lëshuara nga Shteti apo një organ i tij, si dhe dokumentet tjera të lëshuara nga Shteti apo organi i tij, ose nga një agjenci apo organ i Kombeve të Bashkuara, të përcjella me fakte tjera konfirmuese, “Identiteti dhe e drejta e regjistrimit mund të vërtetohet me anë të (...) (c) (...) dokumenteve tjera të lëshuara para datës 10 qershor 1999 nga organet e tjera, duke përfshirë jo vetëm dokumentet e lëshuara nga institucionet arsimore, shëndetësore, politike dhe religjioze, por edhe të shërbimeve publike dhe organeve të tjera kuazi-zyrtare të mbështetura në dëshmi të konfirmuara qoftë me shkrim ose me gojë”.

⁹⁰ Në pajtim me nenin 6.5 të Urdhëresës Administrative nr. 2001/12: “Përveç vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura nga aplikantët në qendrën e regjistrimit, personeli i qendrës së regjistrimit mund të marrë parasysh edhe deklaratat e dëshmitarëve”.

6.2.2. Faktet e pranuar nga QKRC-të si provë e identitetit dhe të drejtës për t'u regjistruar

Në bazë të neneve 4.1 dhe 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13, personat që kërkojnë përfshirje në regjistër duhet të vërtetojnë identitetin e tyre dhe të drejtën e tyre për t'u për regjistrim para Ofiqarit përmes njërës nga këto metoda:

- (a) Me një dokument zyrtar të lëshuar nga cilido shtet apo organ i ngjashëm, duke përfshirë këtu letërnjoftimin, pasaportën apo çfarëdo dokumenti tjetër udhëtimi, që përmban fotografinë ose shenjën e gishtit të kandidatit;
- (b) Me dokumente të tjera të lëshuara nga një shtet apo organ i ngjashëm ose nga cilado agjenci e Kombeve të Bashkuara, të mbështetur, po qe nevoja, me dëshmi të konfirmuara qoftë me shkrim apo me gojë,
- (c) Me dokumente të tjera të lëshuara para datës 10 qershor 1999 nga organet e tjera, duke përfshirë jo vetëm dokumentet e lëshuara nga institucionet arsimore, shëndetësore, politike dhe fetare, por edhe të shërbimeve publike dhe organeve të tjera kuazi-zyrtare të mbështetura në dëshmi të konfirmuara qoftë me shkrim ose me gojë.”

Në pajtim me nenet 5.1 dhe 5.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2001/12⁹¹, “aplikuesi duhet të dëshmojë identitetin e tij apo të saj si kusht paraprak për vërtetimin e përshtatshmërisë civile”, ndërsa këtë mund ta bëjë duke i paraqitur personelit të qendrës së regjistrimit cilindo nga dokumentet në vijim të cilat përmbajnë fotografinë e aplikantit:

- (a) Letërnjoftimin e RFJ-së; (b) pasaportën e RFJ-së; (c) indeksin e universitetit; (ç) librezën e ushtrisë; (d) patentë-shoferin e FRJ-së; (dh) letërnjoftimin e huaj; (e) pasaportën e huaj; (f) patentë-shoferin e huaj ose (g) dokumentin identifikimit zyrtar të refugjatit.

Nëse aplikuesi ka mundësi të paraqes një nga këto dokumente, QKRC-ja është përgjegjëse për shqyrtimin e tyre, vlerësimin e vlefshmërisë së tyre, përcaktimin nëse i përkasin aplikantët, si dhe vendimin nëse ato përbëjnë provë të mjaftueshme të identitetit (neni 5.3). Nëse aplikuesi nuk ka mundësi të paraqesë njërin nga dokumentet e paraqitura më lartë, “...qendra e regjistrimit mund të marrë parasysh dokumente tjera dhe deklaratat e dëshmitarëve, si dëshmi për identitetin në pajtim me procedurat e regjistrimit civil dhe në pajtim me nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/13”⁹².

Duke pasur parasysh këtë kornizë ligjore, EK-të e OMIK-ut iu janë ofruar QKRC-ve për të vërtetuar vullnetin e tyre që ata të marrin parasysh “dokumentet tjera” siç janë faturat e komunalive, edhe nëse nuk janë të paguara, certifikatat e shkollës, dokumentet e lëshuara nga autoritetet serbe ose të strukturave paralele pas vitit 1999, si dëshmi në procesin e vërtetimit të identitetit dhe të drejtës së dëshmitarit. Kur ka qenë e mundur, EK-të gjithashtu kanë mbledhur vlerësimet e ZKK-ve, zyrtarëve komunal për komunitete, UNHCR-së, PDCK-së dhe DAC-i i UNMIK-ut në lidhje me praktikën e QKRC-së në këtë aspekt.

⁹¹ Urdhëresa Administrative nr. 2001/12 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil.

⁹² Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2001/12, neni 5.4.

Siç është e cekur edhe me Fletushkën informative të Zyrës Qendrore të UNMIK-ut për Regjistrim Civil mbi procedurat për regjistrim civil dhe për dokumentet e Udhëtimit⁹³ (Fletushka UNMIK e RQC-së), faturat e komunalive mund të konsiderohen si dëshmi të: kushtit për banim pesë vjeçar (faturat e vjetra dhe të reja të telefonit dhe të rrymës nëse paraqiten të bashkangjitura me dokumentet tjera); dhe adresa e tanishme në Kosovë (faturat e reja të rrymës, telefonit dhe të ujit); certifikatat e shkollës mund të merren si dëshmi të lindjes në Kosovë, ose banimit të pandërprerë pesë vjeçar në Kosovë.

Neni 4.2, pika (c) e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 thotë që identiteti dhe e drejta për regjistrim gjithashtu mund të vërtetohen përmes “(...) (c) dokumenteve tjera të lëshuara para datës 10 qershor 1999 nga organet e tjera, duke përfshirë jo vetëm dokumentet e lëshuara nga institucionet arsimore, shëndetësore, politike dhe fetare, por edhe të shërbimeve publike dhe organeve të tjera kuazi zyrtare të mbështetura në dëshmi të konfirmuara qoftë me shkrim ose me gojë”. Është e qartë se kjo nuk përfshinë dokumentet e lëshuara nga strukturat e Republikës së Serbisë në Kosovë pas qershorit të vitit 1999. Formalisht, QKRC-ja nuk mund t’i konsideroj ato si “dokumente tjera” për qëllim të paracaktimit të identitetit dhe të drejtës së aplikantët për regjistrim civil. Sidoqoftë, ZKK-ja në Viti/Vitina kanë dhënë vërejtje se, ky kufizim mund të paraqes pengesa serioze për regjistrimin civil të të gjithë aplikuesve të cilët, për shkak të zhvendosjes së tyre ose arsyeve tjera të ndryshme, kanë humbur çfarëdo lloj dokumenti dhe mund të paraqesin vetëm dokumentet e lëshuara nga strukturat paralele të Republikës së Serbisë.

Tabela 10: “A është duke i pranuar QKRC-ja gjithashtu edhe faturat e komunalive, edhe nëse ato nuk paguhen, certifikatat e shkollës, dokumentet e lëshuara nga autoritetet serbe ose nga strukturat paralele nëpër komunat veriore të Kosovë pas vitit 1999 si “dokumente tjera” që paraqet dëshmi në procesin e paracaktimit të identitetit dhe të drejtës së aplikantit?”

Përgjigja e QKRC-së	Asnjë nga këto dokumente	% ⁽¹⁾	Faturat e shërbimeve komunale	% ⁽¹⁾	Certifikatat e shkollës	% ⁽¹⁾	Dokumentet e strukturave paralele pas 10 qershorit 1999	% ⁽¹⁾	Të gjitha këto dokumente	% ⁽¹⁾
Po	8	32%	12	48%	12	48%	9	36%	8	32%
Jo	16	64%	12	48%	12	48%	15	60%	16	64%
Nuk janë paraqitur	1	4%	1	4%	1	4%	1	4%	1	4%
Totali	25	100%	25	100%	25	100%	25	100%	25	100%
N/Z ⁽²⁾	7	/	7	/	7	/	7	/	7	/
Totali i përgjithshëm	32	/	32	/	32	/	32	/	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë janë kalkuluar me referencë në institucione për të cilat përgjigja është në dispozicion; (2) N/Z do të thotë as përgjigja nuk ka qenë e dhënë, e as pyetja nuk është parashtruar.

⁹³ Fletushka Informative e Regjistrimit Qendror Civil të UNMIK-ut mbi procedurat për Regjistrim Civil dhe për Dokumentet e Udhëtimit, shtojca 1, Kapitulli i Dokumenteve të Pranueshme, tetor 2004

Përafërsisht gjysma e QKRC-ve të intervistuar (48%) kanë deklaruar se i pranojnë faturat e komunalive⁹⁴ dhe certifikatat e shkollës⁹⁵. Megjithatë, një numër i barabartë i QKRC-ve (48%, ose 12) kanë deklaruar se nuk i pranojnë dokumentet e tilla.⁹⁶ Kjo e rritë brengën për shkak se e kufizon mundësinë e paraparë nga Zyra Qendrore e Regjistrimit dhe më tutje kufizon kapacitetin e aplikuesve të cenusëm për qasje në regjistrim civil, kur ata nuk kanë mundësi të paraqesin dokumentacion shtesë.

Nëntë QKRC⁹⁷ (36%) kanë deklaruar se kanë praktika të marrjes parasysh të dokumentacionit të lëshuar nga strukturat paralele pas 10 qershorit të vitit 1999, si pjesë e procedurës së përcaktimit të identitetit dhe të drejtës së aplikantit për regjistrim civil. Në anën tjetër, pesëmbëdhjetë (60%) QKRC⁹⁸ e interpretojnë ligjin e aplikueshëm në mënyrë më rigorozë dhe nuk i njohin dokumentet e tilla si të vlefshme për qëllime të regjistrimit civil.

Tetë QKRC (32%)⁹⁹ kanë paraqitur qasje më fleksibile duke deklaruar se kanë praktika të marrjes në konsideratë të tri llojeve të dokumenteve në procesin e regjistrimit civil. E kundërt me këtë, tetë QKRC (32%)¹⁰⁰ kanë paraqitur më së paku fleksibilitet duke deklaruar se ato nuk i pranojnë asnjërën nga këto dokumente, ose kanë deklaruar se nuk kanë mundur ta konfirmojnë se a i marrin parasysh faturat e komunalive dhe certifikatat e shkollës.

Sa i përket qasjes drejt dokumenteve të lëshuara nga strukturat paralele të Republikës së Serbisë pas datës 10 qershor të vitit 1999, QKRC-ja në Viti/Vitina ka shkuar edhe më larg duke theksuar se paraqitja e çfarëdo dokumenti të tillë ka qenë bazë për refuzimin e aplikacionit. Nëse kjo praktikë konfirmohet të jetë e tillë, kjo ngrit një brengë serioze për shkak se shkon përtej mos-marrjes parasysh të një dokumenti specifik. Kjo praktikë mund të dekurajojë të kthyerit të cilët kanë vetëm dokumente të strukturave paralele nga aplikimi apo mund të rezultojë edhe me refuzimin e aplikacioneve të tyre. Kjo praktikë ka më shumë gjasa të parqet ndarje të personave të cilët kanë pranuar shërbime nga strukturat paralele, se sa riintegrim të tyre në institucionet dhe shërbimet e IPVQ-ve.

⁹⁴ Gjilan/Gnjilane, Novo Brdo/Novobërdë, Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Rahovec/Orahovac, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić, Lipjan/Lipljan, Skenderaj/Srbica, Zvečan/Zvečan, Vushtrri/Vučitrn, Leposavić/Leposaviq.

⁹⁵ Gjilan/Gnjilane, Novo Brdo/Novobërdë, Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Rahovec/Orahovac, Istog/Istok, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić, Skenderaj/Srbica, Zvečan/Zvečan, Vushtrri/Vučitrn, Leposavić/Leposaviq.

⁹⁶ Raportohet se, Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Prizren, Deçan/Dečane, Klinë/Klina, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Gračanica/Gračanicë, Mitrovicë/Mitrovica nuk i njohin dhe nuk i marrin parasysh dy llojet e dokumenteve. Në anën tjetër Istogu/Istok njih certifikatat e shkollës por jo edhe faturat e komunalive, dhe Lipjani/Lipljan i pranon faturat e komunalive por nuk ceket se i pranon certifikatat e shkollës.

⁹⁷ Gjilan/Gnjilane, Novo Brdo/Novobërdë, Štrpce/Shtërpçë, Rahovec/Orahovac, Obiliq/Obilić, Skenderaj/Srbica, Zvečan/Zvečan, Vushtrri/Vučitrn, Leposavić/Leposaviq.

⁹⁸ Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Prizren, Deçan/Dečane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Gračanica/Gračanicë, Mitrovicë/Mitrovica.

⁹⁹ Gjilan/Gnjilane, Novo Brdo/Novobërdë, Rahovec/Orahovac, Obiliq/Obilić, Skenderaj/Srbica, Zvečan/Zvečan, Vushtrri/Vučitrn, Leposavić/Leposaviq.

¹⁰⁰ QKRC-të në Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Deçan/Dečane, Klinë/Klina, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Gračanica/Gračanicë.

Faktikisht, brenda të njëjtës komunë, ZKK-ja ka vlerësuar se kjo praktikë është problematike për shkak se dokumentet e lëshuara nga strukturat paralele shpesh janë i vetmi lloj i dëshmimit të identitetit, që anëtarët e komuniteteve mund të paraqesin, qoftë personat e zhvendosur, të kthyerit ose individët që kurrë nuk janë larguar nga Kosova.

QKRC-ja në Kamenicë/Kamenica ka deklaruar se i ka pranuar vetëm dokumentet e cekura në Udhëzimin Administrativ nr. 2006/07 të Ministrisë së Shërbimeve Publike (MShP) mbi Përtëritjen e regjistrave të gjendjes civile.¹⁰¹ Duke marrë parasysh legjislacionin dytësor të shpallur me qëllim të përtëritjes së regjistrave të gjendjes civile të cilët janë të zhdukur, të dëmtuar ose të shkatërruar, është e qartë se është esenciale për ato komuna të prekura. Megjithatë, nuk ka asnjë arsye që parandalon QKRC-të e përfshira nga zbatimi i ligjeve të aplikueshme të banimit të përhershëm, duke përfshirë marrjen parasysh të “dokumenteve tjera” kur të caktohet identiteti dhe e drejta e aplikantët, ashtu siç është e dhënë me ligjin e aplikueshëm.

6.2.3. Procedura me dëshmitarë

Ligji i aplikueshëm në Kosovë për regjistrimin e banorëve të përhershëm dhe procedura administrative parashohin mundësinë e përdorimit të deklaratave të dëshmitarëve si mënyrë plotësuese për grumbullimin e dëshmimeve për fakte relevante. Në rast të regjistrimit të gjendjes civile dhe banimit të përhershëm, këto deklarata përbëjnë burim plotësues të dëshmisë në lidhje me identitetin dhe të drejtën për regjistrim.

neni 5.4 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2001/12¹⁰² përcakton që në rast kur aplikuesi nuk ka mundësi të paraqesë cilindo prej dokumenteve të theksuara, me shkrim për identitetin e tij/saj “... personeli i qendrës për regjistrim mund të merr parasysh dokumentet tjera dhe deklaratat e dëshmitarëve, si dëshmi të identitetit në pajtim me procedurat e regjistrimit civil dhe konform nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13”. Njëjtë, neni 6.4 ofron mundësinë e shfrytëzimit të procedurës me

¹⁰¹ Kjo UA i referohet faktit të ripërtëritjes së regjistrave komunal për gjendjen civile të cilët janë zhdukur, ose janë shkatërruar rëndë për shkak të konfliktit. Ai specifikon se pas njoftimit për ripërtëritjen e regjistrave të gjendjes civile, banorët e komunës së përfshirë do të thirren që të përsërisin regjistrimin e tyre në QKRC-në në të cilëen është bërë regjistrimi i tyre i mëparshëm, me sigurimin certifikatës dhe dokumentit të kërkuar: i) certifikata e lindjes, martesës ose e vdekjes e lëshuar në bazë të librave amëz të dëmtuar ose shkatërruar; ii) letërnjoftimi, pasaporta, librezja ushtarake ose dokumentet tjera për të cilat kërkohet certifikata e lindjes; iii) fletë lëshimi nga institucioni mjekësor i lindjes dhe të dhëna nga libri i evidencës së lindjes në spital dhe të dhënat e ngjashme nga institucioni mjekësor; iv) librezja e shkollës dhe certifikata, certifikata dhe diploma e çfarëdo kursi dhe dokumentet tjera që përmbajnë të dhëna për dëshmitë për regjistrim (neni 5.1). gjithashtu siguron që regjistrimi i statusit civil i personave të cilët janë lindur, kanë jetuar dhe vdekur në komunë, por kurrë nuk janë regjistruar nëpër libra të gjendjes civile duhet të bëhet në përputhje me rregullat e regjistrimit të vonuar, siç parashihet me ligjin e aplikueshëm (neni 6). Sipas kësaj, neni 16.4 i Ligjit për regjistrat e gjendjes civile i Kuvendit të Kosovës¹⁰¹ siguron që “dëshmia e lindjes së fëmijës do të regjistrohet në librin amëz të lindjes në afat prej 30 ditëve nga dita e lindjes” dhe neni 16.6 përcakton që “në rastet kur nuk janë raportuar lindjet e fëmijëve në afatin e përshkruar kohor prej 30 ditëve..., regjistrimi bëhet me vendim të organit kompetent...”. Ky quhet regjistrim i vonshëm, ndonëse fushata e UNHCR-së për regjistrimin e gjendjes civile të RAE fokusohet në personat me nevojë për regjistrim të vonshëm.

¹⁰² Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2001/12 që e zbaton Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13 për Regjistrin Qendror Civil.

dëshmitarë në procesin e përcaktimit të drejtës së aplikantët për regjistrim për vendbanim të përhershëm: “krahas vlerësimit dhe rishikimit të dokumentit të paraqitur nga aplikuesi në qendrën për regjistrim, personeli i qendrës për regjistrim mund të merr parasysh deklaratat e dëshmitarëve”.

Përderisa nuk ekziston ndonjë dispozitë e veçantë brenda ligjit të aplikueshëm për regjistrim të gjendjes civile i Kuvendit të Kosovës¹⁰³, procedurat e regjistrimit të gjendjes civile përbëjnë formë të veçantë të procedurave administrative, dhe si të tilla, bien nën dispozitat e përgjithshme të ligjit të zbatueshëm të procedurave administrative. Ligji i Kuvendit të Kosovës për Procedurën Administrative¹⁰⁴ përmban dispozita që kanë të bëjnë me procedurat e hetimit¹⁰⁵, vërtetimit të dëshmisë¹⁰⁶ dhe metodat e paraqitjes së informatës dhe dëshmisë.¹⁰⁷

Përveç kësaj, Ligji i Kuvendit të Kosovës për Procedurën Administrative “(...) do të zëvendësoj të gjitha dispozitat e ligjit të zbatueshëm me të cilin janë në kundërshtim” (neni 142). Nenet 173 deri 181 të Ligjit për Procedurat Administrative të RSFJ-së¹⁰⁸ faktikisht janë në përputhshmëri me dhe e plotësojnë ligjin e Kuvendit të Kosovës për procedurën administrative. Kjo është me referenca të posaçme në rastet në të cilat pala duhet të përdorë deklaratën e dëshmitarëve si dëshmi ose informatë e nevojshme për të përkrahur aplikimin e tij/saj për regjistrim të gjendjes civile ose të banimit të përhershëm. Dispozitat e tilla ndalojnë që çdo “person i cili merr pjesë në procedura si person zyrtar” të veprojnë në cilësinë e dëshmitarit përderisa i jepin të drejtë “çdo personi fizik i cili ka pasur mundësi të perceptojë faktin për të cilin ai/ajo duhet të dëshmojë, dhe i cili ka mundësi të paraqes vështrimin e tij/saj” të veprojnë si dëshmitar (neni 173).

¹⁰³ Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/46 për Regjistrat e gjendjes civile, siç është e nxjerr nëpërmjet rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/21.

¹⁰⁴ Ligji i Kuvendit të Kosovës për Procedurën Administrative nr. 02/L-28, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/33.

¹⁰⁵ Kapitulli II, Procedura Administrative derisa të nxirret Akti Administrativ, Pjesa e I-rë, Procedura Hetimore.

¹⁰⁶ Neni 55.

¹⁰⁷ “58.1 Në rastet kur është e nevojshme për të paraqitur informata ose dëshmi nga ana e palës së interesuar, organi kompetent administrativ do të njoftojë palën me shkrim, ose me gojë në afatin kohor të përcaktuar me dispozitat e këtij ligji.

58.2 Pala e interesuar mund të paraqes informatë me shkrim ose me gojë si dhe dëshmi në çdo kohë në rrjedhën e procedurës administrative ...” (neni 58, paragrafët 1 dhe 2).

¹⁰⁸ Ligji mbi Procedurat Administrative, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 47, 15 gusht 1986. për aq sa nuk është në kundërshtim me Ligjin e Kuvendit të Kosovës për Procedurat Administrative, ky Ligj i RSFJ-së është i zbatueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, e ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut nr. 200/59, sipas së cilës “ligji që ishte në fuqi në Kosovë deri më 22 mars 1989” është i zbatueshëm në Kosovë dhe në rast të konfliktit, rregulloret dhe instrumentet ndihmëse e lëshuara nga UNMIK-u do të kenë përparësi (neni 1.1). Brenda Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara, Ligjet e Kuvendit të Kosovës miratohen nga PSSP-ja nëpërmjet Rregulloreve të UNMIK-ut.

Siç tregon edhe tabela 11, shumica e QKRC-ve¹⁰⁹ (19 ose 76 %) dhe ZKGjC-ve¹¹⁰ (18 ose 66.7%) theksojnë që, kur të jetë e nevojshme, ata i informojnë aplikantët romë, ashkali dhe egjiptianë për mundësinë për t'u drejtuar në procedurën e dëshimit (prapëseprapë kërkohet dokumentacioni përcjellës). Megjithatë, në më së paku pesë komuna¹¹¹, zyrtari komunal për kthim, ZKK-ja, UNHCR-ja, ZKGjC-ja dhe Departamenti i UNMIK-ut për Administratë Civile ose EK-të e OMIK-ut kishin sfiduar deklaratat e tilla ose nuk ishin në dijeni për rastet në të cilat QKRC-të dhe/ose ZKGjC-të i kanë informuar aplikantët romë, ashkali dhe egjiptianë për mundësinë e tillë.

Tabela 11: “A i informon QKRC-ja dhe ZKGjC-ja aplikantët romë, ashkali dhe egjiptianë për mundësinë e sjelljes së dy dëshmitarëve si mënyrë e vërtetimit të identitetit të tyre?”

Përgjigja	QKRC	% ⁽¹⁾	ZKGjC	% ⁽¹⁾
Po	19	76	18	66.7
Jo	3	12	4	14.8
Nuk është paraqitur	3	12	5	18.5
Nën-totali	25	100	27	100
N/z ⁽²⁾	7	/	5	/
Totali	32	/	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë janë kalkuluar me referencë në institucione për të cilat përgjigja është në dispozicion; (2) N/z do të thotë as përgjigja nuk ka qenë e dhënë, e as pyetja nuk është parashtruar.

Në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, tri QKRC (12%) dhe katër ZKGjC (14.8%) haptazi theksuan se nuk i pranojnë apo i përdorin procedurat me dëshmitarë. Në Mitrovicë/Mitrovica, QKRC-ja theksoi që shfrytëzimi i procedurës së dy dëshmitarëve nuk u konsiderua si i mjaftueshëm dhe rastet u referuan në Departamentin e Regjistrimit, Gjendjes Civile dhe Dokumenteve Civile në UNMIK. Ngjashëm me këtë theksoi edhe ZKGjC-ja, e cila tha se e kishte ndërprerë praktikën e përdorimit të deklaratave të dëshmitarëve si mjet për vërtetimin e identitetit. E njëjta vlen edhe për QKRC-në dhe ZKGjC-në në Administratën e UNMIK-ut në veri të Mitrovicës/severna Mitrovica, e cila po ashtu mbulon edhe Zvečan/Zveçanin. Në Pejë/Pec, që të dyja QKRC-të dhe ZKGjC-ja pa të drejtë theksuan që legjislacioni i tanishëm nuk u lejon atyre përdorimin e dëshmitarëve si mjet për të dëshmuar identitetin e aplikantit dhe ZKK-ja konfirmoi që QKRC-ja kishte refuzuar të përdorte procedurën me dëshmitarë në së paku tri raste të të kthyerve romë, ashkali, dhe egjiptianë. ZKGjC-ja në PNjK-në e

¹⁰⁹ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Malishevë/Mališevo, Prizren, Rahovec/Orahovac, Deçan/Dečane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština, Gračanica/Gračanicë, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Leposavić/Leposaviq.

¹¹⁰ Gjilan/Gnjilane, Han i Elezit/Đeneral Janković, Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Malishevë/Mališevo, Prizren, Rahovec/Orahovac, Klinë/Klina, Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Gračanica/Gračanicë, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn.

¹¹¹ Në Kamenicë/Kamenica zyrtarët komunal për kthim dhe ZKK-ja kanë deklaruar që QKRC-ja dhe ZKGjC-ja nuk i kanë informuar aplikantët RAE. Në Gjilan/Gnjilane dhe Viti/Vitina UNHCR-ja dhe ZKGjC-ja nuk kanë qenë në dijeni për praktikën informative të ZKGjC-sëë dhe QKRC-sëë. Duke u bazuar në praktikën ekzistuese gjatë kohës së intervistës, në Gjakovë/Đakovica UNHCR-ja dhe PDCK-ja kishte shprehur mendimin se QKRC-ja dhe ZKGjC-ja nuk do të pranonin dëshmitarë. në Skenderaj/Srbica EK-ja e OMIK-ut kanë gjetur që, edhe përkundër deklaratave të tyre, zyrtarët e ZKGjC-ve dhe QKRC-ve nuk i kanë informuar në mënyrë aktive aplikantët RAE.

Mamuša/Mamushës/Mamuša nuk përdor deklaratat e dëshmitarëve dhe nuk i njofton kërkuesit për këtë mundësi.

Kur QKRC-të¹¹² (3 apo 12%) dhe ZKGjC-të¹¹³ (5 apo 18.5%) e përfshira theksojnë që përdorimi i procedurës me dëshmitarë nuk ka qenë i nevojshëm deri më tani, kjo gjithashtu mund të nënkuptojë që ata nuk i kanë informuar kërkuesit. Për shembull, në Kaçanik/Kaçanik zyrtarët e QKRC-së dhe të ZKGjC-së janë të sigurt që të gjithë parashtruesit e kërkesave nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë janë në dijeni për mundësinë e paraqitjes së dëshmitarëve. Mirëpo, fakti se ende nuk është regjistruar asnjë kërkesë për regjistrim civil në këtë komunë, nënkupton se nuk është bërë asnjë përpjekje proaktive për informim.

Ligji i aplikueshëm në mënyrë të qartë e përcakton procedurën e ankimit e cila zbatohet për regjistrimin e banorëve të përhershëm. Ofiqari duhet të japë arsye me shkrim për refuzimin e tij/saj për të regjistruar aplikuesin, dhe mund të rishqyrtojë një kërkesë të refuzuar më parë nëse sillen dëshmi të reja. Komisioni i Ankesave të Regjistrimit është i themeluar në Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil për të dëgjuar dhe vendosur për ankesat e parashtruara nga aplikuesit¹¹⁴. Përderisa ligji i aplikueshëm për regjistrimin e gjendjes civile¹¹⁵ nuk ka qartësuar se cilat janë mjetet në dispozicion në rastet e refuzimit të kërkesës për regjistrim, ky boshllëk plotësohet përmes mekanizmit të ankesës të paraparë në Ligjin mbi Procedurën Administrative¹¹⁶. Një numër i komunave kanë themeluar bordet për rishqyrtimin e gjendjes civile me qëllim të dëgjimit të rasteve të ndërlikuara të regjistrimit të gjendjes civile, përfshirë ato në të cilat kërkohet procedura me dëshmitarë. Zyrtarët e ZKGjC-së në nëntë komuna përmendën ekzistimin e këshillave të tilla komunale të rishqyrtimit¹¹⁷ apo së paku pranuan që rastet e ndërlikuara iu referohen MShP-së për shqyrtim¹¹⁸. Në tri komuna tjera,¹¹⁹ zyrtarët e ZKGjC-ve thanë që nuk kanë themeluar asnjë bord të rishqyrtimit.

Ekzistojnë një sërë praktikash komunale sa i përket përdorimit të procedurës me dëshmitarë. Në Gjilan/Gnjilane, procedura me dëshmitarë përdoret si mjet për të dëshmuar identitetin dhe QKRC-ja i referon rastet e tilla te Komisioni i Ankesave të Regjistrimit. ZKK-ja është e angazhuar në informimin e aplikuesve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë për përdorimin e kësaj procedure. Në Shtime/Štimlje, ZKK-ja dhe zyrtari për informim publik (ZIP) ka informuar kërkuesit e komuniteteve romë

¹¹² Kaçanik/Kaçanik, Novo Brdo/Novobërdë dhe Štrpce/Shtërpçë.

¹¹³ Kaçanik/Kaçanik, Novo Brdo/Novobërdë, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka dhe Istog/Istok.

¹¹⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil, nenet 6 dhe 7.

¹¹⁵ Ligji i Kuvendit të Kosovës nr 2004/46 për Regjistrat e Gjendjes Civile, i nxjerrë më Rregulloren e UNMIK-ut 2005/21.

¹¹⁶ Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/33.

¹¹⁷ PNJK-ja e Mamuša/Mamushës/Mamuša ku vepron këshilli i akeseve i përbërë prej tre anëtarëve; Prizren, Istog/Istok dhe Klinë/Klina, janë vendet ku këshilli për rishqyrtim nuk ka pasur asnjë rast deri më tani; Rahovec/Orahovac, Obiliq/Obilić, Prishtinë/Priština dhe Gračanica/Gračanicë, ku bordet e ankesave kanë thënë se kanë shqyrtuar rastet në të cilat janë përfshirë edhe deklaratat e dëshmitarëve.

¹¹⁸ Deçan/Dečane.

¹¹⁹ Gjilan/Gnjilane, Gjakovë/Đakovica dhe Mitrovicë/Mitrovica.

ashkali dhe egjiptianë rreth kësaj procedure, si dhe ZKK-ja po ashtu i ndihmon komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë për të gjetur dokumentet e nevojshme për vërtetimin e deklaratave të dëshmitarëve. ZKGjC ka një praktikë të pranimit të procedurave me dëshmitarë për nxjerrjen e certifikatave për të lindurit dhe për të vdekurit por, kërkon dokumentacion shtesë, posaçërisht për personat e lindur para konfliktit. Për të regjistruar identitetin e kërkuesit për personat të cilët banojnë apo kanë banuar jashtë vendit, që të dyja QKRC-të dhe ZKGjC-të kërkojnë që procedura me dëshmitarë të plotësohet me një deklaratë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, UNHCR-ja apo shteti i huaj ku personi jeton apo ka jetuar.

Në Gjakovë/Đakovica, QKRC-ja ka qartësuar se dëshmitarët pranohen vetëm nëse ata posedojnë letërnjoftim. Dëshmitarët pastaj kërkojnë që të nënshkruajnë deklaratat e tyre përpara ofiqarit. ZKGjC-ja theksoi që ata pranojnë regjistrimin me dëshmitar vetëm në rastet e regjistrimit të vonuar dhe lindjeve të cilat bëhen jashtë spitaleve. Në shumicën e rasteve kërkuesit e padokumentuar të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë duhet të shkojnë përmes procedurës së regjistrimit të vonuar. Në rastin e tyre, kjo kërkesë mund të paraqes një barrë të patejkalueshme për shkak se mungesa e certifikatave mbi gjendjen civile dhe mungesa e dokumenteve personale shpeshherë përcjellën nëpër gjenerata dhe shumica e QKRC-ve dhe ZKGjC-ve kërkojnë që dëshmitarët të jenë nga radhët e familjes së ngushtë të kërkuesit. Kërkesa që dëshmitarët të tregojnë identitetin e tyre përmes dokumenteve personale është një kërkesë e dukshme ligjore dhe administrative e cila përdoret nga QKRC-të dhe ZKGjC-të ashtu siç edhe u konfirmua në Prishtinë/Priština dhe Gračanica/Graçanicë.

Në Malishevë/Mališevo, Rahovec/Orahovac, Istog/Istok, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština dhe Gračanica/Graçanicë këshilli i ankesave shqyrton dhe kryesisht miraton rastet ku përfshihen deklaratat të dëshmitarëve. Në Istog/Istok dhe Klinë/Klina, UNHCR-ja dhe PDCK-ja kanë vlerësuar se përdorimi i këshillave të ankesave nuk është i nevojshëm, pasi që në të dy komunat librat e regjistrimit të gjendjes civile janë të padëmtuar. Në Podujevë/Podujevo dëshmitarët duhet të jenë të afërm të aplikuesit dhe këshilli i ankesave bënë vizitë të drejtpërdrejtë te aplikuesi për të mbledhur informata të mëtutjeshme për të vendosur për rastin. Këshilli i ankesave i ka shqyrtuar dhe miratuar 18 raste të tilla vetëm gjatë kohës kur është bërë kjo intervistë. Ngjashëm me këtë këshillat e ankesave në Prishtinë/Priština dhe Gračanica/Graçanicë bëjnë vizita të tilla te aplikuesit të cilët shfrytëzojnë procedurën me dëshmitarë.

Në Deçan/Dečane, ZKGjC-ja nuk ka themeluar këshillin e ankesave por theksoi që, nëse është e nevojshme, rastet e ndërlikuara mund të shqyrtohen nga kryesuesi i ZKGjC-së, zyra ligjore dhe drejtori i QKRC-së. Në vitin 2006, tetë ankesa ndaj vendimeve iu janë dërguar MShP-së, e cila periodikisht konfirmon vendimet e ZKGjC-ve në shumicën e rasteve.

Në Prizren ZKGjC-ja dhe QKRC-ja pranojnë deklaratat e dëshmitarëve në të gjitha rastet. Në Obiliq/Obilić si QKRC-ja ashtu edhe ZKGjC-ja përdorin procedurat me dëshmitar në një masë të madhe, për të mbledhur dëshmi në lidhje me aplikuesit e padokumentuar të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. QKRC-ja, ZKK-ja dhe zyrtari komunal për

kthim bashkëpunojnë në identifikimin e dëshmitarëve. Në Lipjan/Lipljan, zyrtari ndërlidhës për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në ZKK i njofton këto komunitete në mënyrë pro-aktive për dy llojet ekzistuese të regjistrimit civil dhe për procedurën me dëshmitarë. Mirëpo, disa pjesëtarë të këtyre komuniteteve ende po hezitojnë të shkojnë në komunë për t'u regjistruar, për shkak të mungesës së informatave dhe situatës së rëndë ekonomike dhe sociale.

Në Lipjan/Lipljan, QKRC-ja përdorë fletën e vlerësimit fillestar të lëshuar nga Zyra Qendrore e Regjistrimit Civil. Nëse aplikuesi i cili shfrytëzon procedurën me dëshmitar ka lindur pas vitit 1970, QKRC-ja e procedon rastin si të konfirmuar. Në rastet kur aplikuesi ka lindur para vitit 1970, QKRC-ja dërgon fletën e përpiluar të vlerësimit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil për vërtetim. E njëjta procedurë aplikohet nga QKRC-ja në Deçan/Deçane.

Në Vushtrri/Vuçitrn, QKRC-ja dhe ZKGjC-ja përdorin procedurat me dëshmitar vetëm për të identifikuar identitetin e fëmijëve të lindur pas vitit 1997. Edhe pse deri më sot nuk ka pasur raste të tilla, QKRC-ja në Leposaviç/Leposaviq gjithashtu përdor procedurën me dëshmitar për fëmijët.

6.2.4. Prania personale e aplikantit

Sipas nenit 4.2 të Urdhëresës Administrative nr. 2001/12¹²⁰, “Personat të cilët kërkojnë të përfshihen në regjistrin e banorëve të përhershëm të Kosovës duhet personalisht të bëjnë kërkesë në Qendrën komunale të regjistrimit civil në komunën ku ata banojnë...”. Pastaj, neni 4.3 thotë që “Aplikuesit duhet të sjellin me vete në qendrat e regjistrimit të gjitha dokumentet që kanë në dispozicion, të cilat do të ndihmonin për të dëshmuar identitetin dhe përshtatshmërinë e tyre civile dhe ia paraqesin këto dokumente personelit të qendrës së regjistrimit për inspektim dhe shqyrtim”.

Sipas nenit 16.5 të Ligjit të Kuvendit të Kosovës për Regjistrat e Gjendjes Civile¹²¹, regjistrimi i fëmiut të lindur jashtë institucionit shëndetësor kërkon dhënien e një deklarate nga babai ose nëna e tij/saj, personi në shtëpinë e të cilit është bërë lindja, dhe mjekut, personelit të mamive apo personit tjetër i cili ka ndihmuar lindjen. Lindjet që nuk raportohen brenda 30 ditëve i nënshtrohen vendimit për regjistrim nga ZKGjC-ja kompetente pas njoftimit nga aplikuesi (neni 16.6)

Prandaj, të gjithë aplikuesit e padokumentuar, të cilët kërkojnë regjistrim të gjendjes së tyre civile duhet që personalisht të parashtrajnë kërkesën dhe mund të kërkojnë të sigurojnë edhe praninë e dëshmitarëve, përfshirë prindërit e tyre, personin në shtëpinë e të cilit janë lindur, dhe personin i cili e ka ndihmuar lindjen në mënyrë që të vërtetohet fakti i lindjes. Rasti bëhet edhe më i komplikuar kur personi i paregjistruar është i rritur,

¹²⁰ Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2001/12 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil.

¹²¹ Ligji i Kuvendi të Kosovës nr. 2004/46 për Regjistrat e Gjendjes Civile, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/21.

është lindur jashtë vendit apo jashtë institucioneve shëndetësore dhe nuk ka dokumentacion, për të dëshmuar lindjen e tij/saj. Këto raste bëhen edhe më të vështira kur mungesa e dokumenteve bartet nëpër gjenerata dhe kur as prindërit nuk kanë fare dokumente për të dëshmuar identitetin e tyre.

Gjatë fushatës së regjistrimit të komuniteteve romë, ashkali, egjiptianë, UNHCR-ja avokon për fleksibilitet të ZKGjC-ve sa i përket dorëzimit të dokumenteve shtesë me qëllim të shmangies së kufizimeve logjistike ndaj personelit të PDCK-së.

EK-ja e OMIK-ut ka pyetur nëse ZKGjC-të i kanë liruar kërkuesit e ndihmuar nga PDCK-ja apo familjet e tyre, nga kërkesa për të qenë prezent gjatë gjithë kohës së procedurës së kërkesës. Sipas mundësisë, e njëjta pyetje iu parashtrua edhe ZKK-ve, zyrtarëve komunalë për kthim, UNHCR-së, PDCK-së dhe DAC-it të UNMIK.

Siç tregon tabela 12 më poshtë, më shumë se gjysma e ZKGjC-ve (16 apo 53.3%) kanë theksuar që ato i pranojnë deklaratat dhe vlerësimet e UNHCR-së dhe PDCK-së në emër të kërkuesve romë, ashkali dhe egjiptianë pa kërkuar edhe prezencën e tyre. Kjo përqindje është më e ulët (39.2%) sipas UNHCR-së dhe PDCK-së. Në anën tjetër, përgjigjet e ZKGjC-ve dhe PDCK-së e UNHCR-së tregojnë se rreth 30% e ZKGjC-ve¹²² nuk i lirojnë pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë nga detyrimi për të qenë prezent edhe në rastet kur ata përfaqësohen dhe dokumentacioni dorëzohet nga PDCK-ja në emër të tyre.

Tabela 12: “Sa i përket regjistrimit të gjendjes civile, a i beson/pranon ZKGjC-ja vlerësimet dhe deklaratat e UNHCR-së dhe partnerëve implementues të UNHCR-së (PDCK) në mënyrë që të përmbahen nga kërkesa e pranisë së kërkuesit dhe familjes së tij/saj në mënyrë për lëshimin e certifikatës të gjendjes civile?”

A i pranon ZKGjC-ja deklaratat e UNHCR-së apo PDCK-së pa praninë e aplikuesit?	ZKGjC	% ⁽¹⁾	UNHCR dhe PDCK	% ⁽¹⁾
Po	16	53.3	9	39.2
Jo	9	30	7	30.4
Nuk ka ndodhur	5	16.7	7	30.4
Nën-totali	30	100	23	100
n/z ⁽²⁾	2	/	9	/
Totali	32	/	32	/

¹²² Në komunat në vijim ZKGjC-të theksuan që ata nuk i lirojnë aplikuesit e komuniteteve RAE nga detyrimi për të qenë të pranishëm, qoftë edhe kur ata përfaqësohen nga PDCK-ja: PNJK-tëëë nëëë Mamuša/Mamushë/Mamuša; Suharekë/Suva Reka; Deçan/Deçane; Istog/Istok; Klinë/Klina; Pejë/Peć; Mitrovicë/Mitrovica; Zvečan/Zveçan; dhe Laposavić/Leposaviq. Në Kamenicë/Kamenica, ZKGjC-ja u përgjigj duke thënë se, përveç nëse prezantohet një dokument mbi identitetin ai ose ajo nuk mund të lirohet nga detyrimi për të qenë prezent. Aktualisht kjo përgjigje zbulon gatishmërinë për të pezulluar kërkesat në kushte specifike. Në të njëjtën kohë, UNHCR-ja dhe PDCK-ja konfirmuan që ZKGjC-të ishin fleksibile dhe në raste të ndryshme kishin pranuar deklaratat e tyre edhe kur kërkuesit e komunitetit RAE nuk ishin të pranishëm. UNHCR-ja dhe PDCK-ja konfirmuan që sa i përket datës së intervistës, ZKGjC-të në vijim nuk ishin të gatshme të pranojnë deklaratat dhe vlerësimet e PDCK-së në emër të aplikuesve pa praninë e tij/saj: Gjilan/Gnjilane (së paku përkohësisht, për shkak të një rasti të mëvonshëm të mashtrimit ku një çift është përpjekur të regjistrojë një fëmijë i cili nuk ishte i tyre); Novo Brdo/Novobërdë (me siguri jo); PNJK-tëëë nëëë Mamuša/Mamushë/Mamuša; Pejë/Peć; Mitrovicë/Mitrovica; Zvečan/Zveçan; dhe Laposavić/Leposaviq.

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë janë llogaritur në bazë të një reference të vetme ndaj institucioneve për të cilat ekzistojnë përgjigje; (2) N/a do të thotë ose që nuk ka përgjigje ose përgjigja nuk ishte e aplikueshme.

Përgjigjet e UNHCR-së dhe PDCK-së tregojnë që në bazë të vlerësimit të nevojave gjatë fushatës së regjistrimit civil, në shtatë komuna nuk ka pasur nevojë për të kërkuar qasje më fleksibile të ZKGjC-së (30.4%).¹²³

Sipas vlerësimit të UNHCR-së, shumica e aplikuesve të padokumentuar nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë kanë nevojë për regjistrim të njëpasnjëshëm civil. Fillimisht ata kanë nevojë të bëjnë regjistrimin në librin amzë të të lindurve të komunës ku ata jetojnë apo ku janë kthyer dhe vetëm pastaj ata mund të fillojnë procedurat për regjistrim si banorë të përhershëm¹²⁴. Kështu, nuk janë të pajisur as me dokumente personale të identitetit. Zakonisht aplikuesi i cili nuk ka mundësi të kërkojë një certifikatë specifike personalisht, ai/ajo autorizon palën e tretë që ta përfaqësojë atë për të nxjerrë një certifikatë të tillë, duke siguruar një nga dokumentet e tij/saj personale apo fotokopjen të tij. Por në rast se aplikuesi nuk posedon dokumente të identitetit, kjo nuk mund të aplikohet. Këta persona të cenueshëm nuk ekzistojnë në regjistrin e gjendjes civile, e as në regjistrin e banorëve të përhershëm. Ata duhet të kenë qasje në regjistrim të vonuar.

Në këtë kontekst nuk është për tu habitur që ZKGjC-të e kanë vështirë për të proceduar aplikacionet e regjistrimit të vonuar pa praninë e aplikuesit. Ata thjeshtë nuk kanë asnjë dëshmi për ekzistimin e tyre dhe mosprania e aplikuesit e bënë gjetjen e fakteve për lindjen, identitetin dhe të drejtën e tyre më të vështirë.

Disa ZKGjC,¹²⁵ të cilat janë në dispozicion për të proceduar aplikacionet e regjistrimit të vonuar, e kufizojnë fleksibilitetin e tillë vetëm për rastet kur është praktikisht e pamundshme të takohen personat e padokumentuar. Avokati (PDCK), i cili e dorëzon kërkesën në emër të personit të tretë duhet të paraqesë autorizimin e plotfuqishëm të nënshkruar nga aplikuesi dhe kopjen e një dokumenti të identitetit të aplikuesit apo certifikatë që dëshmon regjistrimin e tij/saj në regjistrin e gjendjes civile.

Kërkesat e UNHCR-së dhe PDCK-së për fleksibilitet arsyetohen me procedurat e komplikuar për sigurimin e pranisë së aplikuesve të varfër, të panjohuar dhe shpeshherë të pamotivuar. Rastet bëhen edhe më të komplikuar atëherë kur kërkohet prania e anëtarëve të familjes. E gjithë kjo kërkon nga autoritetet komunale të bëjnë një regjistrim civil proaktiv në zyrat e tyre përmes ekipeve që do të dalin në terren për të siguruar zvogëlim dhe eliminim të personave të padokumentuar në territorin e tyre. Kjo është edhe më e rëndësishme sepse, për shkak të mungesës së regjistrimit civil, personat e tillë kanë më së paku mundësi për të ushtruar të drejtat dhe obligimet e tyre themelore. Kjo prani

¹²³ Štrpce/Shtërpçë, Malishevë/Mališevo, Rahovec/Orahovac, Deçan/Deçane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Skenderaj/Srbica.

¹²⁴ Podujevë/Podujevo ku më tepër se 100 aplikues të komuniteteve RAE kanë marrë certifikata të identitetit është një shembull i qartë në këtë aspekt.

¹²⁵ PNjK-tëëë nëëë Han tëëë Elezit/Đeneral Janković, Kamenicë/Kamenica, Gjakovë/Đakovica, Prizren dhe Lipjan/Lipljan.

kontribuon edhe më tepër në rivendosjen e kushteve të varfërisë, lënien pas dore, dhe padrejtësinë sociale, të cilat kanë ndikim në tërë shoqërinë.

7. Ndikimi i fushatës

Ekipeve komunale (EK) të OSBE-së iu janë qasur zyrtarëve të QKRC-së dhe ZKGjC-së për t'i pyetur nëse kanë vërejtur ndonjë rritje të numrit të pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, të cilët kanë kërkuar dhe janë pajisur me shërbime për regjistrim civil në gjysmën e dytë të vitit 2006. Në shumicën e rasteve, respondentët nuk mundën t'i sigurojnë statistikat, por më mirë shprehën perceptimet e tyre. Kjo është kështu për faktin, që procesi për regjistrimin civil përjashton në mënyrë qartë klasifikimin e aplikantëve sipas komunitetit ose përkatësisë së tyre etnike. Ku ishte e mundur, EK-të diskutuan gjithashtu çështjen e njëjtë me Zyrën Komunale për Komunitete dhe zyrtarin komunal për kthim si dhe me UNHCR-in, PKDC-në dhe DAC-in e UNMIK-ut.

Tabela 13: “Sipas zyrtarit, të cilin e keni intervistuar në gjysmën e dytë të vitit 2006, a kishte ndonjë rritje në numrin e dokumenteve dhe certifikatave të lëshuara për pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë?”

Rritje?	QKRC	% ⁽¹⁾	ZKGjC	% ⁽¹⁾
Rritje	8	30.8	9	33.3
Asnjë ndryshim ⁽²⁾	12	46.1	13	48.2
Zvogëlim	0	0	2	7.4
Asnjë informatë	6	23.1	3	11.1
Nën-totali	26 ¹²⁶	100	27 ¹²⁷	100
N/z ⁽³⁾	6	/	10	/
Totali	32	/	32	/

Legjenda: (1) përqindjet në këtë tabelë janë llogaritur me arsye të vetme ndaj institucioneve për të cilat ka përgjigje; (2) kategoria “asnjë ndryshim” gjithashtu përfshin QKRC-të dhe ZKGjC-të, të cilat siguruan të dhënat, por dështuan të tregojnë nëse ka patur rritje apo jo; (3) pa zbatueshme/jo në dispozicion do të thotë ose përgjigjja nuk ishte në dispozicion ose pyetja në fjalë nuk gjeti zbatim.

Siç ilustron në tabelën 13 të mësipërme, 48.2% të ZKGjC-ve dhe 46.1% të QKRC-ve të intervistuar kanë deklaruar që nuk ka pasur rritje në numrin e lëshimit të dokumenteve pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë¹²⁸. Përveç kësaj, 7.4% e zyrtarëve të ZKGjC-ve pohuan të kanë vërejtur zvogëlim. Prandaj, më shumë se gjysma

¹²⁶ Ferizaj/Uroševac; Gjilan/Gnjilane; Kaçanik/Kaçanik; Kamenicë/Kamenica; Novobërdë/Novo Brdo; Štrpce/Shtërpçë; Viti/Vitina; Gjakovë/Đakovica; Malishevë/Mališevo; Prizren; Rahovec/Orahovac; Suharekë/Suva Reka; Deçan/Deçane; Istog/Istok; Klinë/Klina; Pejë/Peć; Obiliq/Obilić; Fushë Kosovë/Kosovo Polje; Lipjan/Lipljan; Podujevë/Podujevo; Prishtinë/Priština; Mitrovicë/Mitrovica; Skenderaj/Srbica; Zvečan/Zvečan; Vushtri/Vučitrn; Leposavić/Leposaviq.

¹²⁷ Ferizaj/Uroševac; Gjilan/Gnjilane; Shtime/Štimlje; Rahovec/Orahovac; Fushë Kosovë/Kosovo Polje; Podujevë/Podujevo; Prishtinë/Priština; Novo Brdo/Novobërdë; Gjakovë/Đakovica; Kamenicë/Kamenica; Lipjan/Lipljan; Kaçanik/Kaçanik; Deçan/Deçane; Hani i Elezit/Đeneral Janković; Štrpce/Shtërpçë; Malishevë/Mališevo; Prizren; Mamuša/Mamushë/Mamuša; Istog/Istok; Pejë/Peć; Mitrovicë/Mitrovica; Skenderaj/Srbica; Viti/Vitina; Suharekë/Suva Reka; Klinë/Klina; Vushtri/Vučitrn; Leposavić/Leposaviq.

¹²⁸ Në Kamenicë/Kamenica, ku ZKGjC-ja tha që ishte në dijeni për një kërkesë për certifikatë të lindjes dhe Lipjan/Lipljan, ku ZKGjC-ja ka regjistruar 15 raste në vitin 2006.

(55.6%) ose gati gjysma (46.1%) e ZKGjC-ve¹²⁹ dhe QKRC-ve të intervistuar¹³⁰ shprehën mendimin që numër i njëjtë apo madje numër më i vogël i dokumenteve iu janë lëshuar pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.

Në të njëjtën kohë, përafërsisht një e treta e zyrtarëve të intervistuar të QKRC-ve¹³¹ (tetë ose 30.8%) dhe ZKGjC-ve¹³² (nëntë ose 33.3%) kanë vërejtur një rritje në numrin e lëshimit të dokumenteve për banim të përhershëm ose gjendje civile pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Në kuadër të kësaj kategorie, pesë QKRC (19.2%)¹³³ ishin në gjendje të ofrojnë të dhëna lidhur me një ngritje të lehtë¹³⁴ ose më substanciale¹³⁵ dhe tri të tjerat (11.5%)¹³⁶ nuk kanë mundur ta mbështesin vlerësimin e tyre me të dhëna specifike, ngase QKRC-të nuk e regjistrojnë përkatësinë kombëtare të aplikantëve. Në Zvečan/Zveçan vlerësohet që më shumë pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë kanë mbështetje në regjistrim civil dhe lidhet me implementimin në vazhdim të projektit për kthim në mëhallën rome. Ky projekt mbështet kthimin e pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në jug të Mitrovicës/Mitrovica dhe përfshin një komponentë të fuqishme për sa i përket regjistrimit civil të të kthyerve

¹²⁹ Njëmbëdhjetë (40.7%) ZKGjC kanë treguar që nuk ka patur ndryshime në numrin e dokumenteve të lëshuara: Hani i Elezit/Đeneral Janković, Štrpce/Shtërpçë, Malishevë/Mališevo, Prizren, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Istog/Istok, Pejë/Peć, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Kaçanik/Kaçanik dhe Deçan/Deçane. Dy (7.4%) ZKGjC kanë pohuar që më pak pjesëtarë të komuniteteve RAE kanë aplikuar për certifikata të gjendjes civile (Viti/Vitina) dhe asnjë pjesëtar i komuniteteve RAE nuk ka bërë kërkesë për certifikata të gjendjes civile (Leposavić/Leposaviq).

¹³⁰ Në nëntë komuna (34.6%) të ZKGjC-ve nuk kanë vërejtur ndonjë rritje: Shtërpçë/Štrpce; Malishevë/Mališevo; Prizren/Prizren; Deçan/Deçane; Obiliq/Obilić; Fushë Kosovë/Kosovo Polje; Podujevë/Podujevo; Skenderaj/Srbica; Leposavić/Leposaviq. Në dy komuna (7.7%) ZKGjC-të kanë siguruar të dhëna, të cilat nuk tregojnë nëse ka patur ndonjë rritje: Kamenicë/Kamenica (25 kërkesa të regjistruara për letërnjoftime) dhe në Viti/Vitina (janë regjistruar katër pjesëtar të komunitetit RAE që nga qershori 2006). Në Kaçanik/Kaçanik (3.8%) e QKRC-ve nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për dokumente për banim të përhershëm nga pjesëtarët e komuniteteve RAE.

¹³¹ Ferizaj/Uroševac, Istog/Istok, Zvečan/Zveçan, Gjilan/Gnjilane, Rahovec/Orahovac, Prishtinë/Priština, Mitrovicë/Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn.

¹³² Novobërdë/Novo Brdo, Gjakovë/Đakovica, Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Shtime/Štimlje, Rahovec/Orahovac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Podujevë/Podujevo and Prishtinë/Priština.

¹³³ Gjilan/Gnjilane, Rahovec/Orahovac, Prishtinë/Priština, Mitrovicë/Mitrovica and Vushtrri/Vučitrn.

¹³⁴ Siç është raportuar, në Gjilan/Gnjilane numri i dokumenteve të udhëtimit dhe letërnjoftimeve të lëshuara pjesëtarëve të komuniteteve RAE është ngritur nga 98 (janar-maj 2006) deri në 105 (qershor-dhjetor 2006). QKRC-ja në Rahovec/Orahovac ka vlerësuar që më shumë se 100 persona kanë kërkuar dhe/ose pajisur me letërnjoftime dhe dokumente udhëtimi në pjesën e dytë të vitit 2006. Ndonëse, nuk mund të saktësohej që sa pjesëtarë të komunitetit RAE janë pajisur me dokumente të tilla, QKRC-ja e ka vlerësuar këtë si një ngritje të lehtë.

¹³⁵ Zyrtarët e QKRC-së në Prishtinë/Priština nuk kanë ofruar të dhëna të sakta, por kanë pohuar që ka pasur një ngritje përafërsisht prej 50% në numrin e letërnjoftimeve dhe dokumenteve të udhëtimit të lëshuara pjesëtarëve të komuniteteve RAE. Ata kanë shprehur mendimin që aplikantëve të përfshirë RAE u nevojiten dokumente për gjendjen civile/vendbanim të përhershëm, në mënyrë që të ushtrojnë të drejtën për pension. QKRC-ja në Mitrovicë/Mitrovica vlerëson që prej vitit 2005 deri në 2006 ka pasur një ngritje të përgjithshme 70% në numrin e letërnjoftimeve, dokumenteve të udhëtimit dhe certifikatave për regjistrim civil të lëshuara pjesëtarëve të të gjithave komuniteteve. Ndonëse, nuk janë ofruar të dhëna specifike për pjesëtarët e komuniteteve RAE. Në Vushtrri/Vučitrn, QKRC-ja ka konfirmuar që ka pasur një rritje të konsiderueshme në numrin e letërnjoftimeve të lëshuara pjesëtarëve të komuniteteve RAE: 71 që nga qershori 2006.

¹³⁶ Ferizaj/Uroševac, Istog/Istok dhe Zvečan/Zveçan.

potencial¹³⁷. Mirëpo, është me rëndësi të vihet në dukje se regjistrimi civil i të zhvendosurve RAE në pjesën veriore të Kosovës që iniciuar që në vitin 2005 përmes mekanizmit koordinues të Projektit të Kthimit në Mahallën e Romëve. Megjithëse, është regjistruar një numër i madh i rasteve gjatë vitit 2006, ngritja e vetëdijesimit ka qenë duke vazhduar për një kohë më të gjatë.

Në anën tjetër, nëntë ZKGjC (33.3%) kanë dhënë vlerësime (katër ose 14.8%)¹³⁸ apo kanë shprehur mendimin (pesë ose 18.5%)¹³⁹ që kanë lëshuar më shumë certifikata për gjendjen civile për pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.

Përfundimisht, gjashtë¹⁴⁰ (23.1%) zyrtarë të QKRC-ve dhe tre zyrtarë¹⁴¹ (11.1%) të ZKGjC-ve kanë pohuar që nuk posedojnë asnjë informatë specifike lidhur me dokumentet e lëshuara pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë si dhe kanë dhënë arsye të ndryshme, duke përfshirë faktin që:

- Zyrtarët e QKRC-ve nuk i pyesin aplikantët për përkatësinë e tyre etnike dhe asnjë prej dokumenteve të regjistrimit civil nuk përmban informata për përkatësinë etnike të personit¹⁴²;
- Nuk ka ndonjë bazë të të dhënave që i dallon kandidatët dhe bartësit e dokumenteve sipas përkatësisë së tyre etnike¹⁴³; dhe

¹³⁷ EK i OSBE-së në Zvečan/Zvečan ka shprehur mendimin që, në vitin 2006, numri i dokumenteve dhe certifikatave të lëshuara ka pësuar rritje shkaku i projektit për kthim të lagjes romë. Këtu janë të përfshirë në mënyrë aktive UNMIK-u, UNHCR-i, OSBE-ja, Kisha Norvegjeze për Ndhima (NCA), Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) dhe shumë partnerë të tjerë. Një prej prioriteteve të projektit është regjistrimi civil i pjesëtarëve të komuniteteve RAE. QKRC-ja në Zvečan/Zvečan nuk ka mundur të ofroj të dhëna të sakta për shkak të problemeve që kanë pasur me bazën e të dhënave, por kanë dhënë vlerësimin që 85% komuniteteve RAE, që janë strehuar në qendrën kolektive Osterode, në Mitrovicën/Mitrovica e veriut dhe posedonin disa dokumente për ta dëshmuar identitetin e tyre dhe në fakt kanë qenë në gjendje të regjistrohen. QKRC-ja beson që komunitetet e mbetura RAE janë regjistruar në Mitrovicën/Mitrovica e jugut ose diku tjetër në Kosovë.

¹³⁸ Në Podujevë/Podujevo më shumë se 100 aplikantë RAE janë pajisur me certifikata të lindjes gjatë fushatës së organizuar për regjistrim civil, ku kanë qenë të përfshirë ZKGjC-ja, ZKK-ja, udhëheqësit e komunitet RAE dhe PDCK-ja. ZKGjC-ja në Novo Brdo/Novobërdë ka njohur në mënyrë të qartë, që pas nismës së PDCK-së më shumë pjesëtarë të komuniteteve RAE kanë kërkuar dhe janë pajisur me certifikata të gjendjes civile: përafërsisht njëzet certifikata të lindjes, katër mbi gjendjen martesore dhe një akt vdekje. Gjithashtu, në Gjakovë/Đakovica kanë aplikuar më shumë pjesëtarë të komunitetit RAE për certifikata të lindjes dhe çertifikata të gjendjes civile që nga qershori 2006. Kjo ka ndodhur në kontekst të projektit për regjistrim civil të komuniteteve RAE të realizuar nga Karitasi zviceran, GTZ-ja (Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit) dhe ZKK-ja. Në kuadër të këtij projekti, ZKK-ja ka identifikuar personat e paregjistruar në mesin e komuniteteve RAE, Karitasit zviceran dhe GTZ-së, të gjithë kanë bërë pagesën për regjistrim civil. ZKK-ja vlerëson një rritje prej 30% të rasteve të regjistrimit civil të komuniteteve RAE. ZKGjC-ja në Ferizaj/Uroševac ka vlerësuar që gjatë pjesës së dytë të të vitit 2006, numri i certifikatave të lëshuara pjesëtarëve të komuniteteve RAE është ngritur së paku në 50%, por nuk ka pasur të dhëna specifike.

¹³⁹ Gjilan/Gnjilane, Shtime/Štimlje, Rahovec/Orahovac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje and Prishtinë/Priština.

¹⁴⁰ Klinë/Klina, Gjakovë/Đakovica, Pejë/Peć, Suharekë/Suva Reka, Lipjan/Lipljan and Novo Brdo/Novobërdë.

¹⁴¹ ZKGjC-të në Suharekë/Suva Reka, Klinë/Klina dhe Vushtrri/Vučitrn.

¹⁴² QKRC-të në Gjakovë/Đakovica, Pejë/Peć, Klinë/Klina dhe ZKGjC-të në Suharekë/Suva Reka, Klinë/Klina dhe Vushtrri/Vučitrn.

¹⁴³ Suharekë/Suva Reka.

- Ka një numër të vogël të kandidatëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe /ose nuk ka në dispozicion asnjë statistikë.¹⁴⁴

Kur EK-të ia parashtruan pyetjen palëve tjera, duke përfshirë ZKK-në dhe zyrtarin komunal për kthim, UNHCR-në dhe Zyrat e PDCK-së në terren, si dhe më konkretisht DAC-i pranë UNMIK-ut. Ndonëse informatë jo gjithëpërfshirëse, kjo doli në pah sa i përket rezultateve të fushatës në vazhdim në një numër të komunave.

Në Podujevë/Podujevo, ZKGjC-ja dhe QKRC-ja kanë konfirmuar që më shumë se 100 aplikantë romë, ashkali dhe egjiptianë janë pajisur me certifikata të lindjes gjatë një fushate të organizuar për regjistrim civil, ku kanë qenë të përfshirë ZKGjC-ja, ZKK-ja, udhëheqësit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe PDCK-ja.

Zyrat në terren e UNHCR-së dhe PDCK-së në Pejë/Peć kanë qartësuar që PDCK-ja ka 415 raste potenciale të kontrolluara në pesë komuna të rajonit të Pejës/Peć, duke përfshirë 220 në Gjakovë/Đakovica, 86 në Pejë/Peć, 70 në Klinë/Klina, 25 në Deçan/Dečane dhe 14 në Istog/Istok. Ky kontrollim ka çuar në identifikimin e 375 pjesëtarëve të paregjistruar të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Derisa fushata ishte në vazhdim e sipër, PDCK-ja ka qenë në gjendje të sigurojë regjistrimin civil të 70 (18.7%) këtyre rasteve.

Në Gjakovë/Đakovica, UNHCR-i ka theksuar që pasi kombësia e aplikuesit nuk tregohet në certifikatat e gjendjes civile, është vështirë të vlerësohet nëse ka rritje të numrit të pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të cilëve i është siguruar regjistrimi civil. Megjithatë, PDCK-ja tanimë ka intervistuar 220 persona dhe ka ndihmuar 38 pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në pajisjen me regjistrim civil.

Në Ferizaj/Uroševac, PDCK-ja ka treguar që ka ndihmuar në intervistimin dhe përpunimin e 128 aplikacioneve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, me 56 zgjidhje të rasteve, 39 të pazgjidhura, 5 të refuzuara dhe 30 të referuara komunave tjera. Kjo do të thotë që, ndonëse fushata ishte akoma në fazën fillestare dhe që planifikuar të vazhdojë në vitin 2007, më shumë se gjysma e rasteve të referuara komunave janë zgjidhur. Veç kësaj, PDCK-ja u ndihmonte banorëve të komunave tjera, duke iu referuar ZKGjC-ve dhe QKRC-ve kompetente. ZKK-ja dhe zyrtari komunal për kthim gjithashtu e kanë mbështetur fushatën. ZKK-ja ishte në dijeni që janë ndihmuar më shumë se 100 raste dhe ka pohuar që rekomandimet e bëra kanë ngritur vetëdijen sa i përket rëndësisë së regjistrimit civil. Rasti i Ferizajt/Uroševac demonstroi që mbështetja e ZKK-së është e

¹⁴⁴ Lipjan/Lipljan dhe Novobërdë/Novo Brdo. Në rastin e Lipjanit/Lipljan, vlerësimet e 2000 komunave lidhur me popullatën lokale përfshijnë referencat ndaj shqiptarëve, serbëve, kroatëve dhe ndaj 1,890 të tjerëve. Ndonëse, ka gjasë që së paku një pjesë e këtyre të klasifikuar si të tjerët u përkasin komuniteteve RAE, Ky klasifikim mund të jep përshtypjen, që autoritetet komunale u kushtojnë më pak vëmendje komuniteteve RAE. Në rastin e Novobërdës/Novo Brdo ndonëse nuk ka asnjë informatë lidhur me regjistrimin e banimit të përhershëm, ZKGjC-ja ka treguar që implementimi i fushatës për regjistrimin civil të komuniteteve RAE nga PDCK-ja ka rezultuar me një ngritje të numrit të certifikatave të lëshuara të gjendjes civile për përfitime të pjesëtarëve të komuniteteve RAE. Pasi që të pajisen me certifikatat të gjendjes civile, personat e përfshirë kanë qasje më të lehtë në regjistrim për banim të përhershëm.

një rëndësie të veçantë për suksesin e aktiviteteve të fushatës në terren dhe ngritjes së vetëdijes.

Në Mitrovicë/Mitrovica, UNHCR-ja dhe PDCK-ja kanë vërejtur një ngritje në numrin e rasteve të regjistrimit civil të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, që sipas tyre është ngritur prej 10/15 rasteve në vitin 2005 në 105 raste deri në vitin 2006. Gjithashtu, QKRC-ja ka konfirmuar që ka pasur ngritje prej 70% të numrit të letërnjoftimeve dhe dokumenteve të udhëtimit të lëshuara banorëve. Megjithatë, ZKGjC-ja nuk do të pranonte ndonjë rritje.

Zyrtari Komunal për Kthim në Rahovec/Orahovac tregoi se është shtuar numri i kërkesave për regjistrim civil nga komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, për shkak të shtimit të numrit të riatdhesimeve. Pas riatdhesimit të tyre, sipas zyrtarit komunal për kthim, tetëmbëdhjetë familje të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë kanë aplikuar dhe janë pajisur me certifikatë të regjistrimit civil. Është disi për tu habitur, që në komunën e njëjtë ZKK-ja ka deklaruar që zyra e tij/saj ka vendosur të mos mbajë të dhëna, për sa i përket regjistrimit civil sepse pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë lëvizin lirisht. Prandaj, niveli i vetëdijesimit të zyrtarëve komunal, të cilët merren me çështjet për komunitete dhe kthim duket të jetë mjaft i ndryshueshëm.

ZKK-ja në Pejë/Peć, ishte e vetëdijshme se kthimet e vazhdueshme të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në lagjen 7 Shtatori kishin krijuar një ngritje të kërkesës për certifikata të gjendjes civile (30 deri në 40 kërkesa), të nevojshme për t'u pajisur me letërnjoftime dhe dokumente të udhëtimit. Po ashtu, DAC-i i UNMIK-ut kishte vërejtur një numër të rritur të kërkesave për dokumente të regjistrimit civil nga të kthyerit spontan dhe të detyruar romë, ashkali dhe egjiptianë. Shumica e këtyre kërkesave ishin për certifikata të lindjes, të cilat janë të domosdoshme për të hyrë në ciklin e regjistrimit civil.

Në Lipjan/Lipljan, PDCK-ja u përgjigj se ata kishin ndihmuar regjistrimin civil të shtatëmbëdhjetë anëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe se të gjithë aplikuesit ishin liruar nga pagesat komunale si rrjedhojë e intervenimit të tyre. Kjo gjithashtu u konfirmua nga ZKGjC-ja, e cila me sa duket ka regjistruar dhe liruar nga pagesat pesëmbëdhjetë aplikantë romë, ashkali dhe egjiptianë, të ndihmuar nga PDCK-ja.

Në Viti/Vitina, PDCK-ja u përgjigj se kishin qenë në gjendje të intervistonin dhe ndihmonin afro 25 pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Gjashtëmbëdhjetë prej tyre dukej se kishin nevojë për regjistrim civil dhe deri më tani PDCK-ja ka arritur të sigurojë regjistrim civil për nëntë nga ta.

Zyrtari komunal për kthim në Prishtinë/Priština ishte i vetëdijshëm se, brenda kampanjës së vazhduar të regjistrimit civil, ZKGjC-ja dhe QKRC-ja kompetente kishte lëshuar një numër të konsiderueshëm të dokumenteve të regjistrimit civil për pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Kjo është konfirmuar edhe nga QKRC-ja, e cila fliste për një ngritje prej 50% dhe ZKGjC-ja e cila kishte shënuar një ngritje në lëshimein e certifikatave të lindjes, martesës, e të gjendjes martesore, si dhe certifikatave të vdekjes.

8. Rekomandime

I. Për IPVQ-të qendrore:

1. Të themelohet grupi punues ndërministror, duke përfshirë të paktën Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shërbimeve Publike, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe përfaqësuesit komunalë, për të hartuar udhëzimet mbi masat që duhen miratuar nga komunat, në mënyrë që:

- a) Të identifikohen pjesëtarët e paregjistruar të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë;
- b) Të përshpejtohet dhe lehtësohet përpunimi i aplikacioneve të tyre;
- c) Të zgjerohet dhe lehtësohet përdorimi i procedurave me dëshmitarë për të përcaktuar identitetin dhe të drejtën e aplikuesit;
- d) Të lirohen nga pagesat administrative këta aplikues deri në fund të vitit 2007;
- e) Të miratohet një qasje fleksibile dhe të lehtësohet riintegrimi i aplikantëve në Institucionet dhe shërbimet e IPVQ-ve dhe të pranohen dokumentet e lëshuara nga strukturat paralele pas 10 qershorit të vitit 1999, për rastet në të cilat aplikanti nuk asnjë dokument tjetër për të dëshmuar identitetin dhe zotësinë juridike të tij/saj;
- f) Të caktojnë një pikë të kontaktimit për t'u ndërlidhur me UNHCR-në dhe PDCK-në gjatë kampanjës së regjistrimit civil;
- g) Në bashkëpunim me UNHCR-në dhe PDCK-në, të grumbullohen statistikat mujore mbi numrin e aplikacioneve të dorëzuara përmes PDCK-së, dhe numrat e rasteve të zgjidhura, të ndara sipas moshës dhe gjinisë;
- h) Të transmetohen informatat e tilla te zyrat e caktuara brenda IPVQ-ve qendrore;
- i) Të promovohet vetëdija publike mbi rëndësinë e regjistrimit civil dhe të informohet publiku mbi kampanjën aktuale;
- j) Të qaset komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, dhe të ofrohen shërbime të regjistrimit civil përmes ekipeve lëvizëse.

2. T'u sigurohen komunave resurse adekuate për zbatimin e aktiviteteve të nevojshme të regjistrimit të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve;

3. Përmes udhëzimit administrativ, të themelohen (MPB-ja) normat minimale dhe maksimale për çdo certifikatë dhe shërbim të gjendjes civile në mënyrë që të shmanget aplikimi i pagesave joproporcionale në komuna të ndryshme;

4. Përmes një udhëzimi administrativ, të sigurohet themelimi i bordeve të shqyrtimit të gjendjes civile në të gjitha komunat dhe të qartësohet mandati dhe procedurat përmes së cilave bordi i tillë i shqyrtimit do të përcaktojë aplikacionet e vonuara të regjistrimit të gjendjes civile;

5. (MShP, MPB-ja dhe Kuvendi i Kosovës) Të sigurohet se legjislacioni aktual mbi Librin amzë është ndryshuar në mënyrë që të përfshijë një procedurë të qartë të ankesave dhe për të siguruar se ZKGjC-të lëshojnë vendime me shkrim si përgjigje ndaj aplikacioneve të pranuar.

II. Për komunat:

1. Të ndahen burime adekuate nga buxheti komunal për të siguruar veprimin e ekipeve lëvizëse dhe zbatimin e aktiviteteve të kontaktimit mbi regjistrimin civil duke pasur si cak komuniteteve romë, ashkali dhe atë egjiptianë;
2. Të sigurohet një shpërndarje e përmirësuar e dokumenteve dhe udhëzimeve lidhur me procesin e regjistrimit civil të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të të gjitha institucionet përkatëse komunale;
3. Të emërohet personi kontaktues rom, ashkali dhe egjiptian për regjistrimin civil, i cili do të koordinonte përpjekjet komunale dhe do të siguronte dhe grumbullonte të gjitha informatat relevante;
4. Të ketë angazhim në vetëdijësim dhe informim, përmes medimeve lokale;
5. Të lehtësohet krijimi i mekanizmave të koordinimit në të cilat bartësit relevant mund të këmbëjnë informata dhe të planifikojnë iniciativa të përbashkëta;
6. Të adoptohet një qasje e ndjeshme ndaj gjinive, e cila do të ndihmonte nënat dhe foshnjat në rast të lindjeve shtëpiake dhe do të promovonte regjistrim civil të të gjitha foshnjave të porsalindura;
7. Të angazhohen ekipet lëvizëse komunale në aktivitete të informimit dhe edukimit që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor të nënave dhe fëmijëve; regjistrimin civil me lindje; vaksinimet e obligueshme; qasja në shërbimet komunale të kujdesit shëndetësor; dhe angazhimin e stafit të kujdesit shëndetësor primar dhe të sistemeve të mirëqenies sociale në aktivitete të tilla;
8. Të fuqizohet bashkëpunimi me komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë (udhëheqësit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë; grupeve të grave dhe vajzave romë, ashkali dhe egjiptiane; mamitë dhe stafin jomjekësor që ndihmojnë lindjet shtëpiake brenda vendbanimeve specifike romë, ashkali dhe egjiptiane) dhe institucionet tjera përkatëse (ZKK-të, zyrtarët komunalë të kthimit, departamentet komunale të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe qendrat e shëndetësisë familjare; qendrat për punë sociale) në aktivitete të tilla të kontaktimit;
9. Kurdoherë që është e mundur, të punësohen pjesëtarë të kualifikuar të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, përfshirë gratë, jo vetëm brenda QKRC-ve, ZKGjC-ve dhe ZKK-ve, por edhe në qendrat e mjekësisë familjare dhe të promovohen punësimet e tilla nga ana e qendrës për punë sociale;
10. Të inkurajohet angazhimi i stafit të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në aktivitetet e informimit dhe kontaktimit që kanë si cak komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe që përfshijnë regjistrimin civil dhe shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Shtojca 1

Komunat dhe pilot-njësitë komunale në të cilat ekipet komunale të OSBE-së kanë grumbulluar informatat që përmbahen në këtë raport.

Rajoni i OSBE-së	Komunat	Pilotnjësitë komunale
Gjilan/Gnjilane	Gjilan/Gnjilane	Hani i Elezit/Đeneral Janković
	Kamenicë/Kamenica	
	Novobërdë/Novo Brdo	
	Shtërpçë/Štrpce	
	Kaçanik/Kaçanik	
	Viti/Vitina	
	Ferizaj/Uroševac	
	Shtime/Štimlje	
Nën-totali	8	1
Prizren	Prizren	Mamuša/Mamushë/Mamuša
	Suharekë /Suva Reka	
	Malishevë /Mališevo	
	Rahovec /Orahovac	
	Gjakovë /Đakovica	
Nën-totali	5	1
Prishtinë/Priština	Prishtinë/Priština	Gračanica/Graçanicë*
	Podujevë/Podujevo	
	Obiliq/Obilić	
	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	
	Lipjan/Lipljan	
Nën-totali	5	1
Pejë/Peć	Pejë/Peć	Junik
	Deçan/Dečane	
	Istog/Istok	
	Klinë/Klina	
Nën-totali	4	1
Mitrovicë/Mitrovica	Mitrovicë/Mitrovica	
	Skenderaj/Srbica	
	Vushtrri/Vučitrn	
	Zveçan/Zvečan	
	Mitrovicë/Mitrovica North**	
	Leposaviq/Leposavić	
Nën-totali	5	0
Gjithsej	28	3+1*

Legjendë: * Gračanica/Graçanicë nuk është NjPK, por ka disa zyra dhe shërbime administrative që janë lëndë e këtij raporti; ** Administrata e UNMIK-ut Mitrovicë Veri /Mitrovica (UAM).

Shtojca 2: Pagesat komunale (në euro) të zbatuara për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile

Lloji i certifikatës	Komuna ⁽¹⁾																														
	FE/UR	GN	HE/DJ	KA	KK	NB	SM	ST	VI	GJ/DA	ML	MM	PZ	RH	SR	DC	JU	IS	KL	PE	OB	FK/KP	LI	PJ	PR	MI	SE	ZV	MIN	VU	LE
E lindjes ⁽²⁾	1.00	1.50	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	0.50	0.50	1.00	1.00	1.50	1.50	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00
E martesës ⁽³⁾	1.00	1.50	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	0.50	0.50	10.00	1.00	1.50	1.50	2.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00
E gjendjes martesore ⁽⁴⁾	1.00	6.50	2.50	2.50	2.00	2.00	5.00	1.00	2.50	3.00	10.00	1.00	1.00	3.00	5.00	1.50	1.50	2.00	3.00	1.00	1.00	3.00	1.00	5.00	1.00	1.00	5.00	1.00	1.00	1.00	1.00
E pranimit të atësisë / amësisë ⁽⁵⁾	1.00	2.50	0.00	1.00	5.00	0.00	5.00	nz	2.50	0.00	1.00	nz	nz	1.00	nz	1.50	1.50	2.00	1.50	1.00	1.00	1.00	0.00	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	0.00	1.00
E shkurorezimit (e pasqyruar në certifikatën e gjendjes martesore) ⁽⁶⁾	1.00	1.50	1.00	1.00	1.00	2.00	5.00	nz	2.50	0.00	1.00	0.50	1.00	3.00	5.00	1.50	1.50	2.00	3.00	1.00	1.00	3.00	1.00	5.00	1.00	1.00	5.00	1.00	1.00	0.00	1.00
Certifikatë e vdekjes ⁽⁷⁾	1.00	1.50	1.00	1.00	2.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	0.50	0.50	1.00	5.00	1.50	1.50	2.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Dëshmia se personi është gjallë ⁽⁸⁾	1.00	2.50	1.00	1.00	2.00	2.00	1.00	1.00	2.50	3.00	10.00	1.00	1.00	10.00	5.00	1.50	1.50	2.00	3.00	2.00	1.00	1.00	5.00	3.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00
Zëvendësimet bazuar në arkivin e regjistrit ⁽⁹⁾	6.00	2.50	1.00	1.00	5.00	8.00	1.00	1.00	nz	6.00	nz	2.50	0.50	1.00	0.00	2.50	2.50	2.00	nz	1.00	1.00	nz	1.00	1.00	1.00	0.00	nz	0.00	0.00	nz	0.00
Deklarata e dëshmitarit ⁽¹⁰⁾	0.00	2.50	2.50	1.00	1.00	nz	1.00	0.00	2.00	1.00	1.00	nz	0.50	1.00	0.00	2.50	2.50	2.00	nz	1.00	1.00	1.00	1.00	0.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	0.50	1.00
Vendimi për të lejuar regjistrimin në librin amzë ⁽¹¹⁾	6.00	3.50	5.00	1.00	5.00	nz	1.00	0.00	5.00	6.00	1.00	1.00	0.50	3.00	0.00	1.50	1.50	2.00	5.00	5.00	1.00	nz	1.00	2.00	2.00	3.00	0.00	3.00	3.00	0.00	3.00
Ndryshimet në certifikata ⁽¹²⁾	6.00	3.50	5.00	1.00	5.00	8.00	5.00	nz	5.00	6.00	1.00	nz	0.50	3.00	5.00	3.50	3.50	2.00	5.00	nz	1.00	8.00	1.00	5.00	2.00	3.00	10.00	3.00	3.00	10.00	3.00

Legjendë:(1) Në këtë tabelë, komunat janë përshkruar bazuar në akronimet në vijim: Ferizaj/Uroševac (FE/UR); Gjilan/Gnjilane (GN); Hani i Elezit/Đeneral Janković (HE/DJ); Kaçanik/Kaçanik (KA); Kamenicë/Kamenica (KK); Novo Brdo/Novobërdë (NB); Shtime/Štimlje (SM); (ST); Viti/Vitina (VI); Gjakovë/Đakovica (GJ/DA); Malishevë/Mališevo (ML); Mamuşa/Mamushë/Mamuša; (MM); Prizren (PZ); Rahovec/Orahovac (RH); Suharekë/Suva Reka (SR); Deçan/Dečane (DC); Junik (JU); Istog/Istok (IS); Klinë/Klina (KL); Pejë/Peć (PE); Obiliq/Obilić (OB); Fushë Kosovë/Kosovo Polje (FK/KP); Lipjan/Lipljan (LI); Podujevë/Podujevo (PJ); Prishtinë/Priština (PR); Mitrovicë/Mitrovica (MI); Skenderaj/Srbica (SE); Zvečan/Zvečan (ZV); UAM Mitrovicë/Mitrovica North (MIN); Vushtrri/Vučitrn (VU); Leposaviq/Leposaviq (LE).

(2) Certifikata e lindjes: Prizreni dhe Mamuşa/Mamushë/Mamuša kanë tarifën më të ulët prej 0.5 €. Njëzet komuna aplikojnë tarifë prej 1 €. Ajo më e larta është në Skenderaj/Srbica dhe Istog/Istok, me 2 €.

(3) Tarifa e Certifikatës së martesës është jashtëzakonisht e lartë në Rahovec/Orahovac (10.00 €).

(4) & (6) Tarifat e certifikatës së gjendjes martesore ndryshojnë nga 1 € në trembëdhjetë komuna deri në 6.5 € dhe madje arrijnë kulmin prej 10 € në Malishevë/Mališevo.

(5) Pranimi i atësisë/amësisë: Ky shërbim është pa pagesë në katër komuna (Vushtrri/Vučitrn, Lipjan/Lipljan, Gjakovë/Đakovica, Novo Brdo/Novobërdë) dhe në një NjPK (Hani i Elezit/Đeneral Janković). Çmimi më i lartë prej 5 € ngarkohet në Kamenicë/Kamenica dhe Shtime/Štimlje. (7) Certifikata e vdekjes në Suharekë/Suva Reka paguhet 5 €.

(8) Dëshmia se një person është gjallë: tarifa arrin 10 € në Rahovec/Orahovac dhe Malishevë/Mališevo.

(9) Zëvendësimet e bazuara në arkivin e regjistrit: Ky shërbim është pa pagesë në katër komuna: Leposaviq/Leposaviq, Zvečan/Zvečan, Mitrovicë/Mitrovica dhe Suharekë/Suva Reka. Ai arrin shumën prej 8.00 € në Novo Brdo/Novobërdë.

(10) Deklarata e dëshmitarit: pa pagesë në komunat Ferizaj/Uroševac, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka dhe Podujevë/Podujevo.

(11) Vendimi për të lejuar regjistrimin në librin amzë është pa pagesë vetëm në katër komuna. Ai arrin shumën prej 6.00 € në Ferizaj/Uroševac dhe Gjakovë/Đakovica.

(12) Tarifat për ndryshimet në certifikata janë jashtëzakonisht të larta, 10.00 € në Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn.